

VENDIM
Nr. 887, datë 27.12.2022

PËR PROCEDURAT E MENAXHIMIT TË INVESTIMEVE PUBLIKE

(ndryshuar me VKM nr. 70, datë 14.2.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16 dhe 25, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Projekti i investimit përfshin një seri punimesh, aktiviteteve apo shërbimesh, që synojnë përmbushjen e një objekti të pandashëm, me qëllime qartësisht të identifikuara, *pavarësisht burimit të financimit*. Kostoja totale e një projekti investimi do të përfshijë çdo shpenzim, që lidhet me arritjen e rezultateve të synuara, sipas të gjithë komponentëve të tij.

2. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim, përcakton kufirin financiar të vlerës së plotë të projektit në përputhje me specifikat e sektorit, mbi bazën e të cilit, përcaktohet mënyra dhe procedura e vlerësimit të projektit të investimit publik.

3. Projektet e reja të investimeve publike mbi vlerën kufi të vendosur me udhëzim nga ministri përgjegjës për financat klasifikohen si projekte investimi me rëndësi strategjike dhe i nënshtrohen procesit të vlerësimit për përfshirjen e tyre në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare. Këto projekte investimi përfshihen në PBA-në apo buxhetin vjetor në përputhje me hapësirën fiskale, vetëm pasi të jenë bërë pjesë e listës unike të projekteve me rëndësi kombëtare, të rankuar dhe të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. *Përfshirja nga ky rregull bëjnë projektet e investimeve publike që lidhen me rikonstruksionin e ndërtesave publike, blerjen e pajisjeve elektronike apo të pajisjeve të zyrave.*

4. Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare përmban projektet e investimeve publike, që kanë rëndësi strategjike, për sa i përket zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, pavarësisht nga burimi i tyre i financimit. Kjo listë shërben si instrument për mbështetjen e politikave dhe prioritetëve të qeverisë shqiptare, në linjë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), si edhe strategjitë sektoriale e ndërsektoriale. Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare shërben si referencë për ministrinë përgjegjëse për financat dhe njësitë e qeverisjes qendrore, në kuadër të përfshirjes së projekteve të investimeve publike në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) apo buxhetin vjetor.

5. Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, jo më vonë se data 31 janar. Nëse vlerësohet e nevojshme, Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare rishikohet, jo më vonë se data 1 korrik. Autoriteti përgjegjës për administrimin, përditësimin dhe ndjekjen e procedurave për miratimin e listës unike të projekteve me rëndësi kombëtare është institucioni përgjegjës për programimin strategjik.

6. Klasifikimi i shpenzimeve kapitale për efekt të vlerësimit dhe programimit të projekteve të investimeve publike është, si më poshtë vijon:

a) “*Shpenzime kapitale administrative*” përkufizohen si *zëvendësimi i pajisjeve të vjetruara gjatë ushtrimit të funksioneve nga njësi e qeverisjes qendrore apo blerje të pajisjeve të reja që lidhen me nivelin aktual të personelit ose rritjen e numrit të stafit. Njësitë e qeverisjes qendrore përgatitin propozimet dhe i paraqesin në ministrinë përgjegjëse për financat të shoqëruara me dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me procedurat për vlerësim sipas aneksit 1, në përputhje me përcaktimin e nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Projektet e vlerësuara sipas këtij klasifikimi do të paraqiten si pjesë përbërëse e kërkesave buxhetore, në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm*

(PBA). Ministria përgjegjëse për financat shqyrton propozimet, duke i përfshirë, sipas rastit, në procesin e PBA-së apo buxhetin vjetor.

b) Shpenzime kapitale për emergjenca: janë shpenzimet që bëhen për t'iu përgjigjur një nevoje të menjëhershme për investime publike, si rezultat i krizës humanitare dhe/ose një aksidenti madhor në një zonë ose objekt të caktuar, një fenomen i rrezikshëm natyror apo i shkaktuar nga njeriu, fatkeqësi natyrore ose ekologjike (mjedisore), epidemi, përdorim të armëve që shkaktojnë ose mund të çojnë në viktima njerëzore, dëme të konsiderueshme për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin. Njësitë e qeverisjes qendrore përgatitin propozimet në çdo kohë dhe i paraqesin të shoqëruara me dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me procedurat për vlerësim, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Ministria përgjegjëse për financat shqyrton dhe miraton, duke i përfshirë në buxhetin vjetor, vetëm projektet emergjente të propozuara me vlerë, deri në 200 000 000 (dyqind milionë) lekë. Në rastet kur vlera e projekteve emergjente të propozuara tejkalon vlerën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë, këto propozime përcillen për miratim me vendim të Këshillit të Ministrave. Pas miratimit, ministria përgjegjëse për financat i përfshin në buxhetin vjetor.

c) Shpenzime për projekte investimesh: janë shpenzime të bëra për një seri punimesh, aktiviteteve apo shërbimesh, me qëllim qartësisht të identifikuar, që janë pjesë e kostos së një programi të caktuar buxhetor dhe nuk janë shpenzime kapitale administrative.

7. Financimi i projekteve të investimeve publike bëhet në përputhje me metodologjinë e përgatitjes së buxhetit, miratuar nga ministria përgjegjëse për financat, në udhëzimet standarde dhe vjetore të përgatitjes së buxhetit. Projektet e investimeve publike, që financohen si pjesë e një programi të caktuar në ligjin vjetor të buxhetit, mund të jenë projekte ekzistuese dhe të reja. *Gjatë procesit të programimit të projekteve të investimeve publike prioritet për financim kanë projektet ekzistuese.*

Në shpenzimet për projekte të investimeve publike ekzistuese përfshihen:

a) shpenzimet e investimeve kapitale për projekte, që janë financuar në vitin fiskal aktual dhe nuk kanë përfunduar;

b) shpenzimet e investimeve kapitale për projekte që ende nuk kanë filluar, por për të cilat janë ndërmarrë angazhimet ligjore dhe janë miratuar në procesin e mëparshëm të Programimit Buxhetor Afatmesëm (PBA).

Të gjitha investimet e tjera publike do të trajtohen si investime të reja.

8. Propozimet për projektet e reja të investimeve, *pavarësisht burimit të financimit*, të cilat përmbushin kriteret për t'iu klasifikuar si projekte me rëndësi strategjike, sipas kriterëve të tabelës 1, në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe vlerës kufi të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës të financave, do të përgatiten nga njësitë e qeverisjes qendrore, sipas dokumentacionit dhe procedurave të përcaktuara për vlerësim në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Propozimet do të paraqiten njëkohësisht në ministrinë përgjegjëse për financat dhe në institucionin përgjegjës për programimin strategjik, në çdo kohë.

a) Ministria përgjegjëse për financat përcjell pranë institucionit përgjegjës për programimin strategjik qëndrimin e saj për çdo propozim për projektet e reja të klasifikuara si projekte me rëndësi strategjike, jo më vonë se 14 ditë nga data e marrjes së propozimit nga njësitë e qeverisjes qendrore;

b) Në kuadër të përfshirjes së projekteve të reja të investimeve të propozuara nga njësitë e qeverisjes qendrore në listën unike të projekteve me Rëndësi Kombëtare, institucioni përgjegjës për programimin strategjik, vlerëson dhe konsulton çdo propozim në Komitetin e Planifikimit Strategjik, rast pas rasti;

c) *Për projektet e investimeve publike, të cilat përfshihen në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, përpara maturimit, institucioni propozues paraqet studimin e fisibilitetit, duke siguruar cilësinë e tij në përputhje me përcaktimet e shtojcës 4, bashkëlidhur këtij vendimi, për të cilat:*

i. ministria përgjegjëse për financat vlerëson përballueshmërinë buxhetore të projektit dhe risqet fiskale lidhur me deficitin buxhetor dhe borxhin publik;

ii. institucioni përgjegjës për programimin strategjik jep mendim për plotësimin e dokumentacionit sipas kritereve të këtij vendimi dhe rivlerësimin e përputhshmërinë me strategjitë kombëtare, sektoriale dhe ndërsektoriale;

iii. Agjencia e Trajtimin të Koncesioneve (ATRAKO) jep mendim në tërësi për përmbushjen e elementeve të studimit të fizibilitetit të projektit, vetëm për projektet që paraqiten sipas modulit PPP.

ç) Projekti konsiderohet i maturuar me miratimin e Komitetit të Planifikimit Strategjik.

ç/1) Institucioni përgjegjës për programimin strategjik reflekton ndryshimin e statusit të maturitetit të projekteve që maturohen dhe rivlerëson rankimin e projekteve në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare.

d) Propozimet për projektet e reja të investimeve, të cilat nuk përmbushin kriteret për t'u klasifikuar si projekte me rëndësi strategjike, sipas kritereve të tabelës 1, në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe vlerës kufi, të miratuar me udhëzim të ministrit të financave, do të përgatiten nga njësitë e qeverisjes qendrore, sipas dokumentacionit dhe procedurave të përcaktuara për vlerësim në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Propozimet do të paraqiten në ministrinë përgjegjëse për financat, sipas përcaktimit në nenin 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

9. Bazuar në rankimin e projekteve të maturuara në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare dhe në përputhje me hapësirën fiskale, ministria përgjegjëse për financat përgatit dokumentin e PBA-së, duke përfshirë në të prioritetet buxhetore, miratimin e politikave të reja dhe tavanin e vendosur të shpenzimeve, i cili i paraqitet për miratim Këshillit të Ministrave.

10. Parimet kryesore, ku bazohen njësitë e qeverisjes qendrore për vlerësimin, priorizimin dhe propozimin e projekteve të investimeve; institucioni përgjegjës për programimin strategjik për vlerësimin e propozimeve të projekteve të investimit për përfshirjen e tyre në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare; si dhe ministria përgjegjëse për financat për vlerësimin përfundimtar për përfshirjen e tyre në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) apo buxhetin vjetor, janë:

- a) parimi i vlerësimit të rëndësisë strategjike;
- b) parimi i vlerësimit ekonomik dhe financiar;
- c) parimi i vlerësimit mjedisor dhe impaktit klimaterik;
- ç) parimi i vlerësimit të qëndrueshmërisë;
- d) parimi i vlerësimit gjinor;
- dh) parimi i vlerësimit të menaxhimit të projektit.

11. Për angazhimet buxhetore shumëvjeçare, që lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë zbatimit të tyre nuk lejohet që në buxhetin e njësisë përkatëse të njësisë së qeverisjes qendrore të shpërndahen më pak se 20% e vlerës së plotë të projektit përkatës gjatë vitit të parë. Gjatë zbatimit të projekteve të investimeve publike nuk lejohet që në buxhetin e njësisë përkatëse të njësisë së qeverisjes qendrore të shpërndahen më pak se 30% e vlerës së plotë të projektit përkatës gjatë vitit të dytë dhe jo më pak se 30% e vlerës së plotë të projektit përkatës gjatë vitit të tretë, përveç rasteve ku përcaktohet ndryshe në dokumentin e studimit të fizibilitetit dhe projektet e reja të miratuara në PBA 2023-2025. Për projektet e investimeve publike me financim të huaj ndiqen rregullat e përcaktuara në marrëveshjet përkatëse me institucionin financiar.

12. Monitorimi dhe raportimi i ecurisë së zbatimit të projekteve të investimeve kryhen, sipas afateve dhe procedurave specifike, që jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe udhëzimet përkatëse të monitorimit të buxhetit të shtetit.

13. Përjashtimisht, për vitin 2023, Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare miratohet, jo më vonë se data 28 shkurt.

13/1. Projektet e investimeve me statusin "i maturuar" në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, të miratuara me vendimin nr. 447, datë 26.7.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2024–2026", përfshihen në PBA apo buxhetin vjetor, pasi:

- a) institucioni përgjegjës për programimin strategjik të kryejë rankimin e projekteve;
- b) ministria përgjegjëse për financat të vlerësojë përballueshmërinë buxhetore të projektit në përputhje me hapësirat fiskale.

14. Vendimi nr. 185, datë 29.3.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, shfuqizohet.

15. Ngarkohen të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2023.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKS 1. PROCEDURAT E MENAXHIMIT TË INVESTIMEVE PUBLIKE

Procedurat e mëposhtme do të aplikohen në procesin e planifikimit të investimeve publike. “Projekt investimi”, si pjesë përbërëse e programit të shpenzimeve publike është: “një seri punimesh, aktiviteteve apo shërbimesh, që synojnë të përmbushin një objektiv të pandashëm të një natyre specifike ekonomike apo teknike, me qëllime qartësisht të identifikuar”.


Cikli i Projektit konsiderohet si pjesë integrale e Ciklit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike (MSHP). Mund të ndodhë që cikli i një projekti mund të mos përputhet nga pikëpamja kohore me ciklin e Menaxhimit të Shpenzimeve Publike.

Kjo për arsyet:

i) Cikli i MSHP duhet të përputhet në mënyrë të plotë me kalendarin e një viti fiskal, ndërsa fazat e një projekti individual mund të jenë më të gjata se sa fazat korresponduese të MSHP;

ii) Mund të ndodhë që disa projekte financohen nga donatorët dhe zakonisht donatorë të ndryshëm mund të kenë cikle dhe procedura të ndryshme nga ato të MSHP. Në këtë kontekst, këto procedura synojnë të ndërtojnë një proces që lidh në mënyrë integrale procesin e menaxhimit të projekteve të investimeve me procesin e përgjithshëm të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike.

Diagrama e mëposhtme përshkruan fazat e Ciklit të Menaxhimit të Investimeve Publike.



Proceset dhe procedurat e secilës fazë të ciklit janë të rëndësishme sepse sigurojnë që projekti të menaxhohet në mënyrë efektive dhe të arrijë qëllimin e tij.

1. Identifikimi i projektit është procesi i identifikimit e shqyrtimit të ideve për projekte investimi të bazuara në analizën e nevojave publike, ndërhyrjeve të qeverisë dhe përshtatjes me strategjitë kombëtare dhe sektoriale.

2. Vlerësimi dhe përgatitja e projektit është procesi i analizës dhe vlerësimit të efektivitetit ekonomik dhe financiar, si dhe i mundësisë së realizimit të projektit;

3. Aprovimi dhe financimi i projektit është faza në të cilën projekti shqyrtohet dhe aprovohet për financim nëpërmjet procesit të përgatitjes dhe financimit të PBA-së për njësitë të qeverisjes qendrore përkatëse;

4. Zbatimi i projektit është faza në të cilën projekti zbatohet dhe realizohen *output*-et e tij;

5. Monitorimi i zbatimit të projektit është procesi përmes të cilit njësitë të qeverisjes qendrore dhe në veçanti institucionet përgjegjëse për zbatimin e projekteve sigurojnë që aktivitetet që ata po zbatojnë janë në përputhje me aktivitetet e programuara.

6. Vlerësimi dhe Auditimi është faza e ciklit në të cilën raportimi për zbatimin fizik dhe financiar të projektit auditohet kundrejt rregullave financiare dhe realizimit të treguesve të performancës së projektit. Objekt i raportimit dhe monitorimit nga ana e njësisive të qeverisjes qendrore që zbatojnë projekte të investimeve publike, do të jenë të gjitha projektet e investimeve publike që financohen në kuadër të buxhetit të shtetit, pavarësisht burimit dhe vlerës së financimit.

Fazat nëpër të cilat kalon procesi deri në miratimin e projektit të investimit janë:
FAZA I – Identifikimi i projekt-idesë nëpërmjet analizës së problemit dhe argumentimit për investim (hapi 1, hapi 2, hapi 3);
FAZA II – Përgatitja dhe dërgimi i propozimit të Projektit të Investimit (hapi 4, hapi 5);
FAZA III – Analiza, Miratimi dhe Financimi i Projekt-Propozimeve të Investimeve Publike(hapi 6, hapi 7, hapi 8, hapi 9).

Hapat kryesorë të ndjekur sipas fazave të mësipërme në mënyrë skematike janë:



FAZA I: Identifikimi

Hapi 1 – Identifikimi i projekt-idesë

Projekt-idetë për investime prezantohen nga “Propozuesit e Projektit” (ose siç quhen ndryshe, “Menaxherët e Projektit”), të cilët janë përgjegjës për Programin në të cilin bën pjesë projekti i investimit.

Tre elementët bazë të fazës së identifikimit të projekt-idesë janë:

Analiza e prioriteteve ----- është një analizë e prioriteteve sektoriale dhe kombëtare.

Analiza e problemeve ----- është një analizë për identifikimin e problemeve që ekzistojnë duke i renditura ato sipas rëndësisë së tyre, duke identifikuar një relacion të mundshëm shkaktues.

Analiza e Nevojave dhe përkufizimi i objektivave të investimit ----- krijimi i një pikturë të situatës, ku aspektet negative konvertohen në zgjidhje, të cilat më vonë kthehen në objektiva që duhen përmbytur.

Projekt-idetë prezantohen në Formularin (F-1) sipas Shtojcës 1.

Formulari i Identifikimit të Projekt-Idesë duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- i) Emri i Propozuesit të Projektit - Zyrtari që përgatit Formularin e Projekt-Idesë dhe detajet kontaktuese;
- ii) Emri i Institucionit Buxhetor - p.sh., Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- iii) Vendndodhja - Vendi ku do të kryhet investimi;
- iv) Ideja e Projektit - Një përshkrim i shkurtër i idesë së projektit;
- v) Problemet që do të adresohen - Një shpjegim i shkurtër dhe i qartë i problematikës së gjendjes aktuale, e cila pengon arritjen e qëllimeve dhe objektivave të politikave të programit dhe mënyrën se si projekti i propozuar ndihmon në kapërcimin e problematikës aktuale;
- vi) Emri i Programit - Ky është emri i programit ashtu siç shfaqet në Dokumentin e PBA-së dhe buxhetin vjetor;
- vii) Vlerësimet paraprake të kostove - Një vlerësim paraprak i kostos së parashikuar të projektit.

Hapi 2 – Rishikimi i projekt-idesë nga DEMP

Formulari (F-1) dorëzohet tek Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Projektit (DEMP).

EMP-ja duhet të diskutojë mbi: (i) idenë e projektit për investim; (ii) mbi problemet që do të adresohen nga projekti; dhe (iii) koston paraprake të investimit në fjalë.

DEMP-ja mund të pranojë ose të refuzojë projekt-idenë. Në rast të refuzimit, në Formularin (F-1), jepet një shpjegim i shkurtër dhe i qartë i arsyeve për refuzimin e projekt-idesë.

Në rast pranimit, DEMP-ja duhet të dorëzojë Formularin (F-1) tek Sekretari i Përgjithshëm ose tek drejtuesi i institucionit buxhetor, nëse nuk ka Sekretar të Përgjithshëm.

Hapi 3 – Rishikimi i Projekt-idesë nga Sekretari i Përgjithshëm (SG), Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS)

Sekretari i Përgjithshëm duhet të bëjë një vlerësim paraprak mbi domosdoshmërinë e një ndërhyrjeje me investim publik në fushën përkatëse dhe njëkohësisht vlerëson nëse informacioni i dhënë në Formularin (F-1) siguron faktin që projekti është i pranueshëm dhe i realizueshëm nga pikëpamja financiare dhe teknike. Më pas, në rast pranimit e përcjell për miratim në GMS.

Arsyet për pranimin ose refuzimin e projekt-idesë nga Sekretari i Përgjithshëm jepen në Formularin (F-1), në seksionin përkatës.

FAZA II: Përgatitja dhe dërgimi i kërkesës së Projektit të Investimit

Hapi 4 – Përgatitja dhe vlerësimi i detajuar i projektit - Plotësimi i Formularëve

Përshkrim i investimit, së bashku me alternativat e konsideruara, duhet të prezantohet në Formularin (F-2) për kategorinë “*Shpenzime kapitale administrative*”, ose në Formularin (F-3) për kategoritë “*Shpenzime kapitale për emergjenca*” dhe “*Shpenzime për projekte investimesh*”.

Për projektet e investimit në kategorinë “*Shpenzime për projekte investimesh*”, të cilat klasifikohen si projekte me rëndësi strategjike sipas kriterëve të *Tabelës 1* dhe vlerës kufi të përcaktuar me udhëzime të ministrit përgjegjës së financave, në mënyrë që të bëhen pjesë e Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare të rankuar, krahas Formularit (F-3) duhet të plotësojnë informacionin e kërkuar edhe mbi vlerësimin e Relevancës Strategjike për sektorin përkatës.

Formulari i Relevancës Strategjike (FRS) - përmbajtja e dokumentit, mënyra e plotësimit dhe dërgimit të këtij informacioni përcaktohet me urdher të titullarit të institucionit përgjegjës për programimin strategjik;

Projektet e përfshira në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, me qëllim renditjen dhe priorizimin e tyre, duhet të kenë edhe Studimin e Fisibilitetit. Pasja e Studimit të Fisibilitetit, nuk përbën kusht për përfshirjen në Listën Unike të Projektiteve me Rëndësi Kombëtare, por përbën kusht për përfshirjen e projektit të investimit në PBA. Gjithsesi, ky kusht nuk i heq të drejtën projekt propozuesit për të kërkuar financim për të realizuar Studimin e Fisibilitetit dhe çdo financim tjetër për të maturuar projektin e investimit.

Njësitë të qeverisjes qendrore duhet të marrin masa për të siguruar që informacioni me të cilin janë plotësuar Formularët (F-2) apo (F-3), Relevanca Strategjike dhe/ose Studimi i Fisibilitetit, është i plotë dhe cilësor për të rritur shanset e pranimit dhe financimit të projekt propozimit. Për të gjitha pyetjet në formularët përkatës projekt-propozimi duhet të marrë vlerësimin “kalim”, përndryshe do të kthehet për zhvillim të mëtejshëm.

Hapi 5 – Dërgimi i kërkesës të projektit të investimit

Përpara dërgimit të kërkesës së projektit të investimit, njësitë të qeverisjes qëndror e duhet të sigurohen që:

- a) *Të rishikohet Propozimi i Projektit për Investim nga DEMP-ja.*
Me marrjen e Formularëve F-2 ose F-3, relevancën strategjike dhe/ose studimin e fisibilitetit, Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Projektit (DEMP) duhet të mbledhë Ekipin e Menaxhimit të Projektit (EPM), për të diskutuar mbi propozimin e projektit për investim, koston dhe përfitimet e tij dhe përcjelljen e propozimit të projektit për investim, në Departamentin e Financës dhe Departamentin e Politikave.
- b) *Të rishikohet Propozimi i Projektit për Investim nga Departamenti i Financës dhe Buxhetit dhe Departamenti i Politikave.*
DEMP-ja duhet të diskutojë me Departamentin e Buxhetit/Financës të institucionit mbi propozimin e projektit për investim e sidomos mbi llogaritjet e koston dhe përfitimit të projektit të investimit në fjalë, duke përfshirë këtu edhe aspektet sociale, gjinore, ndikimet klimatike dhe ambientale të realizimit të tij, si dhe mundësitë buxhetore të institucionit për ta përballuar këtë investim.
- c) *Të rishikohet Propozimi i Projektit për Investim nga Sekretari i Përgjithshëm (SP). Sekretari i Përgjithshëm vendos nëse projekti duhet t'i kalojë Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS). Në rast se SP e pranon propozimin e projektit të investimit, më pas ai/ajo ia paraqet për shqyrtim GMS të institucionit përkatës.*
- d) *Të rishikohet Propozimi i Projektit për Investim nga Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS).*

Pas miratimit nga GMS, çdo Ekip i Menaxhimit të Programit duhet të prioritetizojë projektet e investimeve të çdo programi respektiv, për përfshirjen e tyre në PBA apo Buxhetin Vjetor. Projekt propozimet për investime të mëdha mund të kalojnë tavanin e miratuar për Institucionin Buxhetor.

- e) *Të hartohet lista e projekteve të reja për investim sipas prioriteteve.*
Parimet kryesore mbi të cilat do të mbështetet ky vlerësim do të jenë:
 - **Parimi i rëndësisë strategjike** – lidhja e projekt propozimit me strategjitë dhe prioritetet e qeverisë;
 - **Parimi ekonomik dhe financiar** – përfitimet totale të projekt-propozimit duhet të justifikojnë koston totale të financimit;
 - **Parimi i vlerësimit mjedisor dhe impati klimatik** - projekt-propozimi duhet të marrë në konsiderat ndikimin në mjedis, duke marrë parasysh përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike;
 - **Parimi i vlerësimit të qëndrueshmërisë** - projekt-propozimi duhet të ketë efektivitet afatgjatë dhe të qëndrueshem në kohë;
 - **Parimi i vlerësimit gjinor** - projekt-propozimi duhet të ketë një plan të qartë ku burri dhe gruaja gëzojnë mundësinë dhe aksesin e barabartë në të drejta dhe përfitime të së njëjtës natyrë;
 - **Parimi i menaxhimit të projektit** – projekt-propozimi duhet të ketë një plan të qartë dhe gjithëpërfshirës të realizimit dhe menaxhimit të riskut për të siguruar zbatimin e suksesshëm të tij.

Projekt-propozimet e investimeve përcillen në Ministrinë përgjegjëse për financat shoqëruar me dokumentacionin përkatës, nëpërmjet paraqitjes normale të kërkesave për shpenzime sipas afateve të PBA-së/Buxhetit Vjetor.

Përrjashtim nga ky rregull, do të bëjnë vetëm ato propozime projektesh investimi, që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- i) **Klasifikohen sipas pikës 6, gërma b) e VKM, “Shpenzime kapitale për emergjencë”.**
Projekt-propozimet për këtë kategori mund të paraqiten në çdo kohë pranë ministrisë

përgjegjëse për financat të shoqëruara me Formularin (F-3), sipas Shtojcës 3;

ii) **Klasifikohen si projekte investimi me rëndësi strategjike**

Projekt-propozimet për projektet e reja të investimeve të cilat përmbushin kriteret për tu klasifikuar si projekte me rëndësi strategjike sipas kriterëve të Tabelës 1 dhe vlerës kufi të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës së financave, do të paraqiten sipas Formularin (F-3), njëkohësisht në ministrinë përgjegjëse për financat dhe në Institucionin përgjegjës për programimin strategjik, në çdo kohë.

Tabela 1: Klasifikimi i Projekteve Strategjike

| SEKTORI | PËRSHKRIMI | NËNSEKTORI | VLERA |
|---------------------------|---|--------------------------------------|---|
| Digjital | Infrastruktura Digjitale, i referohet teknologjive digjitale, të cilat ofrojnë bazën për teknologjinë dhe operacionet e informacionit të një njësie organizative. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Infrastrukturës Digjitale të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori. | Ndërlidhja me Bazë të Gjerë | Vlera kufi do të përcaktohet me udhëzim të Ministrit përgjegjës për Financat. |
| | | Infrastruktura e-GOV | |
| | | Sisteme informacioni | |
| | | Platformat e Inovacionit | |
| Zhvillimi Ekonomik | Zhvillimi Ekonomik, i referohet programeve dhe politikave, apo aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim të përmirësojnë mirëqenien ekonomike dhe cilësinë e jetës së burrave dhe grave të komunitetit në vend. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Zhvillimit Ekonomik të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori. | Agrikultura | |
| | | Zhvillimi i Biznesit | |
| | | Infrastruktura Bregdetare dhe Detare | |
| | | Sipërmarrja | |
| | | Industria | |
| | | Zhvillimi Rajonal | |
| Energjia | Energjia, i referohet aktiviteteve ekonomike me impakt në prodhimin dhe shitjen e energjisë, përfshirë nxjerrjen e karburanteve, përpunimin dhe shpërndarjen e tyre. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Energjisë të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori. | Eficienta e Energjisë | |
| | | Prodhimi I Energjisë | |
| | | Transmetimi I Energjisë | |
| | | Gazi | |
| | | Nafta | |
| Mjedisi | Mjedisi, i referohet aktiviteteve ekonomike të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Mjedisit të gjitha Projektet e Investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori. | Energjia e Rinovueshme | |
| | | Menaxhimi I Fatkeqësive | |
| | | Mbrojtja nga Përmbytjet | |
| | | Zhvillimi I Qëndrueshëm | |
| | | Menaxhimi I Mbetjeve, Landfillet | |
| Social | Sektori Social, i referohet programeve dhe politikave, apo aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim reduktimin e shtrirjes së varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së burrave dhe grave të në vend si dhe adresimin e pabarazive gjinore në përgjithësi. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit Social të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori. | Furnizimi me Ujë | |
| | | Kultura | |
| | | Edukimi dhe Sportet | |
| | | Shëndetësia | |
| | | Strehimi | |
| | | Siguria e Brendshme | |
| | | Drejtësia | |
| Mbrojtja Sociale | | | |
| Transporti | Transporti, i referohet aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për | Transporti Ajror | |

| | |
|---|--|
| qëllim zhvillimin apo përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese të transportit të mallrave dhe / ose qytetarëve nëpërmjet tokës, ujërave dhe ajrit. Do të konsiderohen si pjesë e të Transportit të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori. | Transporti në Ujërat e Brendshme, Portet |
| | Transporti Hekurudhor |
| | Transporti Rrugor |

FAZA III: Analiza, Miratimi dhe Financimi i Projekt-Propozimeve të Investimeve Publike

Hapi 6 – Analiza e Projekt-Propozimeve nga Ministria përgjegjëse për financat dhe SASPAC

Ministria përgjegjëse për financat- pasi propozimet mbërrijnë në ministrinë e përgjegjëse për financat, Drejtori i Përgjithshëm i Buxhetit i delegon ato në Drejtorinë e Analizës dhe Programit Buxhetor (DAPB), e cila është përgjegjëse për mbledhjen e të gjitha kërkesave për shpenzime në kuadër të PBA-së/Buxhetit Vjetor për çdo institucion buxhetor, sektor/program si dhe në Drejtorinë e Menaxhimit të Investimeve Publike (DMIP) për rishikim dhe vlerësim përfundimtar.

Ministria përgjegjëse për financat shqyrton:

- Formularët shoqërues (F-2) për projektet e reja të cilat klasifikohen sipas **pikës 6, gërma a) “Shpenzime kapitale administrative”** të VKM-së;
- Formularët shoqërues (F-3) për projektet e reja, për projekt-propozimet të cilat klasifikohen sipas **pikës 6, gërma b) “Shpenzime kapitale për emergjenca”** të VKM-së;
- Formularët shoqërues (F-3) për projektet e reja, për projekt-propozimet të cilat klasifikohen sipas **pikës 6, gërma c) “Shpenzime për projekte investimesh”** të VKM-së. Ministria përgjegjëse për financat përcjell pranë Institucionin përgjegjës për programimin strategjik, qendrimin për çdo propozim për projektet e reja të klasifikuara si projekte strategjike, sipas kriterëve të *Tabelës 1* dhe vlerës kufi të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës së financave, jo më vonë se 14 ditë nga data e marrjes së kërkesës nga njësitë e qeverisjes qendrore.

Institucionin përgjegjës për programimin strategjik shqyrton formularin (F-3) dhe Relevancën Strategjike për projekt-propozimet e klasifikuara me rëndësi strategjike, mbi bazën e të cilave kryen vlerësimin e propozimeve, konsultimin rast pas rasti në Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS), si edhe pikëzimin dhe përfshirjen e tyre në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare.

Hapi 7 – Miratimi nga Ministria përgjegjëse për financat

Ministria përgjegjëse për financat, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të projekt-propozimeve për investime, harton listën përfundimtare të projekteve të investimeve publike, të cilat do të buxhetohen, të renditur sipas prioritetëve strategjike të zhvillimit ekonomik të vendit.

- Ministria përgjegjëse për financat, pasi shqyrton dhe vlerëson projekt-propozimet për investime, e klasifikuara sipas **pikës 6, gërma a) “Shpenzime kapitale administrative”**, miraton propozimet duke i përfshirë në PBA apo Buxhetin Vjetor.
- Ministria përgjegjëse për financat, pasi shqyrton dhe vlerëson projekt-propozimet për investime e klasifikuara sipas **pikës 6, gërma b) “Shpenzime kapitale për**

emergjenca”, miraton duke përfshirë në PBA apo Buxhetin Vjetor, propozimet me vlerë deri në 200,000,000 lekë. Në rastet kur vlera e projekteve emergjente të propozuara tejkalon 200,000,000 leke këto propozime përcillen për miratim në Këshillin e Ministrave. Pas miratimit, ministria përgjegjëse për financat i përfshin në PBA apo Buxhetin Vjetor;

- Ministria përgjegjëse për financat, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të projekt-propozimeve për investime, miraton projektet e investimeve publike duke i përfshirë në PBA apo Buxhetin Vjetor, të cilat klasifikohen sipas **pikës 6, gërma c) “Shpenzime për projekte investimesh”** të VKM-së, por që nuk përmbushin kriteret për tu klasifikuar si projekte strategjike sipas kriterëve të *Tabelës 1* të këtij Aneksi dhe vlerës kufi të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës së financave;
- Ministria përgjegjëse për financat, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të projekt-propozimeve për investime, miraton projektet e investimeve publike duke i përfshirë në PBA apo Buxhetin Vjetor, të cilat klasifikohen sipas **pikës 6, gërma c) “Shpenzime për projekte investimesh”** të VKM-së dhe përmbushin kriteret për tu klasifikuar si projekte strategjike sipas kriterëve të *Tabelës 1* të këtij Aneksi dhe vlerës kufi të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës së financave, bazuar në rankimin e projekteve të gatshme për financim, në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe në përputhje me hapësirën fiskale.

Hapi 8 – Rishikimi nga Këshilli i Ministrave

Pasi rishikohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe diskutohet me institucionet buxhetore, në dëgjuesat që organizohen në kuadër të PBA-së, drafti i PBA-së, si dhe Buxhetit Vjetor paraqitet në Këshillin e Ministrave për rishikim përfundimtar dhe miratim.

Hapi 9 – Miratimi përfundimtar i projektit dhe përfshirja në PBA/ Buxhetin Vjetor

Pas miratimit në KM të projekteve të investimeve në kuadër të PBA/buxhetit vjetor, lista e projekteve të investimeve paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë vetëm si tabelë shoqëruese e paketës së PBA/Buxhetit vjetor, por që nuk miratohet nga Kuvendi.

ANEKS 2: METODOLOGJIA

“PËR MONITORIMIN DHE RAPORTIMIN E INVESTIMEVE PUBLIKE”

Rregullat e mëposhtme do të aplikohen në procesin e monitorimit dhe raportimit të investimeve publike.

1. Rregulla të Përgjithshme të Monitorimit

Monitorimi është procesi përmes të cilit njësitë e qeverisjes qendrore, përgjegjëse për zbatimin e projekteve të investimeve publike, sigurojnë që realizimi financiar i projekteve dhe aktivitetet që ato po zbatojnë në këtë kuadër, janë në përputhje me planet vjetore të miratuara në nivel projekti dhe treguesi performance, të përcaktuar gjatë përgatitjes së tij.

Monitorimi do të zhvillohet si një proces sistematik, i cili ka për qëllim të krahasojë nëpërmjet treguesve të performancës, zbatimin e investimeve në tërësi me objektivat për të cilat janë programuar, si dhe marrjen në kohë të masave paraprake për mënjanimin e risqeve dhe problemeve gjatë realizimit të projekteve të investimeve.

Monitorimi i projekteve të investimeve publike do të bëhet duke marrë parasysh specifikat dhe procedurat që ndiqen në zbatimin e projekteve sipas burimit të financimit.

Qëllimi

Metodologjia e Monitorimit dhe Raportimit të Investimeve Publike ka për qëllim të standardizojë formën dhe mënyrën e raportimit nga ana e njësive të qeverisjes qendrore. Kjo metodologji është në përputhje me udhëzimet për hartimin dhe zbatimin e buxhetit dhe rregullon marrëdhëniet ndërinstitucionale në fushën e monitorimit dhe raportimit të investimeve publike në përputhje me përgjegjësitë shtetërore të njësive të qeverisjes qendrore. Në këtë aneks përcaktohet dhe roli i Ministrisë përgjegjëse për financat në monitorimin e procesit të zbatimit të projekteve të investimeve publike, në monitorimin e performancës financiare dhe jo financiare të projekteve përkatëse si dhe afatet e paraqitjes së raporteve në sektorin përgjegjës për monitorimin e projekteve të investimeve publike.

Objektivat e monitorimit të projekteve të investimeve publike

- Të përmirësojë efencën e sistemit aktual të monitorimit të investimeve publike:

Sistemi i monitorimit synon një raportim efikas dhe realist që identifikon në kohë dhe i paraprin akumulimit të problemeve, duke vënë në dijeni strukturat vendimmarrëse me qëllim zgjidhjen në kohë të tyre.

- Të përmirësojë procesin e planifikimit vjetor dhe afatmesëm në nivel programi dhe projekti:

Gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të monitorimit do të ndihmojnë njësitë e qeverisjes qendrore të përmirësojnë mënyrën e planifikimit të projekteve, duke mundësuar një përjasje më të mirë në raport me arritjen e objektivave sektoriale, rishikimin e politikave dhe buxhetimin e programeve

- Të përmirësojë kuadrin institucional të monitorimit e raportimit si dhe përgjegjësitë në procesin e planifikimit

Ministria përgjegjëse për financat përgjigjet për përgatitjen e standardeve dhe metodologjisë së raportimit si dhe për vlerësimin periodik të projekteve dhe programeve të investimeve publike. Sipas rastit, ministria përgjegjëse për financat propozon zgjidhje të mundshme të problemeve të projekteve, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes qendrore.

2. Procedurat e Monitorimit dhe Raportimit të Investimeve Publike

Fusha /Objekti i raportimit

Objekti i monitorimit dhe raportimit nga ana e njësive të qeverisjes qendrore që zbatojnë projekte të investimeve publike, do të jenë të gjitha projektet e investimeve publike që financohen në kuadër të buxhetit të shtetit, pavarësisht burimit dhe vlerës së financimit.

Burimi i të dhënave të monitorimit dhe forma e raportimit

Të dhënat bazë për monitorimin dhe vlerësimin e projekteve të investimeve publike gjenerohen nga raportimet e njësisë të qeverisjes qendrore që zbatojnë projekte me financim të brendshëm dhe të huaj, nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) dhe Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar (SIMF). Sipas rastit, mund të shfrytëzohen edhe burime të tjera të dhënash.

Forma dhe mënyra e raportimit të investimeve publike përcaktohet nga Ministri përgjegjës për financat sipas akteve nënligjore në fuqi.

Afatet e Raportimit

Raportimi për ecurinë e realizimit të investimeve publike do të bëhet në mënyrë periodike në bazë mujore. Raportimi mbi bazë mujore ka për qëllim disiplinimin e investimeve, evidentimin dhe shmangien në kohë të problematikës që haset në zbatimin e projekteve. Raportimi do të bëhet sipas standardit të parashikuar në seksionin e mësipërm.

Të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore që zbatojnë projekte investimi, brenda datës 10 të çdo muaji duhet të dërgojnë pranë strukturës përgjegjëse për monitorimin e projekteve të investimeve publike në ministrinë përgjegjëse për financat raportet e monitorimit për muajin paraardhës. Struktura përgjegjëse për monitorimin e projekteve të investimeve publike në Ministrinë përgjegjëse për financat, brenda datës 20 të çdo muaji përditëson raportin përmbledhës të monitorimit të investimeve për periudhën. Në përputhje me ciklin e buxhetimit të projekteve dhe të përgatitjes dhe zbatimit të buxhetit, raporti për progresin 6-mujor të zbatimit të investimeve do të shërbejë si bazë për rialokime të mundshme të shpenzimeve për investime në kuadër të rishikimit të buxhetit të shtetit. Raporti 9-mujor do të jetë raporti kryesor për vlerësimin e realizimit të prishëm vjetor të investimeve si dhe përgatitjen e propozimeve për tavanet sektoriale të investimeve publike në kuadër të hartimit të projektbuxhetit për vitin në vazhdim. Raporti vjetor i monitorimit të investimeve publike për periudhën ushtrimore hartohet brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.

Kuadri institucional i monitorimit

Ministria përgjegjëse për financat është institucioni përgjegjës për përcaktimin e standardeve të monitorimit dhe të vlerësimit të ecurisë së zbatimit të investimeve në përputhje me prioritetet e miratuara në fillim të vitit buxhetor.

Ministria përgjegjëse për financat siguron që menaxhimi i buxhetit për investime publike nga njësitë e qeverisjes qendrore kryhet në përputhje me parashikimet fillestare dhe në momentin kur konstatohen devijime nga këto parashikime propozon /rekomandon ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve, njëkohësisht duke evidentuar impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.

Ministria përgjegjëse për financat nëpërmjet strukturës përgjegjëse për monitorimin e projekteve të investimeve publike vlerëson kërkesat e njësisë të qeverisjes qendrore për rialokime të burimeve financiare në përputhje me përcaktimet e nenit 44 të ligjit 9936 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, njëkohësisht duke u bazuar edhe në raportet e monitorimit të bëra nga institucionet e qeverisjes qendrore.

Struktura përgjegjëse për monitorimin e projekteve të investimeve publike në Ministrinë përgjegjëse për financat përgjigjet për ndjekjen dhe respektimin e afateve të raportimit, garantimin e cilësisë së raportimit nga ana e njësisë të qeverisjes qendrore që zbatojnë projekte investimi.

Ministria përgjegjëse për financat përgatit raporte përmbledhëse periodike dhe vjetore të monitorimit të investimeve publike.

Njësiti e qeverisjes qendrore përcaktojnë strukturat përgjegjëse për raportimin pranë Ministrisë përgjegjëse për financat /strukturës përgjegjëse për monitorimin e projekteve të investimeve publike, të cilat raportojnë në mënyrë periodike, në rrugë shkresore dhe elektronike, në përputhje me formatet e raportimit të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi. Strukturat përgjegjëse për monitorimin në njësiti e qeverisjes qendrore bëjnë verifikimin, dhe sipas rastit edhe korrektimet apo plotësimet e nevojshme të informacionit të dërguar nga drejtoritë ose institucionet e varësisë, në përputhje me specifikimet e përcaktuara në formatet e miratuara. Çdo njësi e qeverisjes qendrore, brenda sistemit të vet dhe në përputhje me programet që menaxhon, ndërton skemën e raportimit të brendshëm për të gjitha strukturat brenda ose jashtë saj, që zbatojnë projekte të investimeve publike.

Njësiti e qeverisjes qendrore, si institucione përgjegjëse për kontraktimin dhe zbatimin e projekteve, kanë një rol të dyfishtë: evidentimin e termave kontraktuale të projekteve, ndjekjen e zbatimit të projekteve dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve në përputhje me kontratat e lidhura për çdo projekt.

Njësiti e qeverisjes qendrore raportojnë pranë strukturës përgjegjëse për monitorimin e projekteve të investimeve publike në Ministrinë përgjegjëse për financat informacione mbi:

- a) Vlerësim të përgjithshëm mbi arritjet dhe problematikat mbi ecurinë e projekteve të Investimeve Publike për periudhën përkatëse;
- b) Ecurinë financiare për çdo projekt investimi;
- c) Mospërputhjet mes ecurisë fizike të projektit dhe planit të financimit duke argumentuar mospërputhjet;
- d) Projektet e investimeve për të cilat mund të jenë krijuar detyrime të prapambetura dhe arsyet e krijimit të tyre;
- e) Statusin e prokurimit publik për projektet që realizohen nëpërmjet prokurimit;
- f) Afatet e nisjes së zbatimit dhe përfundimit të projektit;
- g) Pritshmëritë mbi realizimin e projekteve deri në fund të vitit buxhetor;
- h) Propozime për korrigjime/rialokime të fondeve buxhetore;
- i) Ecurinë e ndikatorëve të performancës për çdo 4-mujor;
- j) Komente mbi problematikat që kanë ndikuar ecurinë e projektit.

Njësiti e qeverisjes qendrore krahas informacionit të mësipërm në raportin vjetor të monitorimit raportojnë pranë strukturës përgjegjëse për monitorimin e projekteve të investimeve publike në Ministrinë përgjegjëse për financat edhe informacionin mbi:

- a) Projektet të cilat nuk u arritën që të realizohen gjatë vitit buxhetor duke argumentuar arsyet e mosrealizimit.
- b) Projektet të cilat janë mbyllur përfundimisht gjatë vitit buxhetor si dhe evidentimin e rasteve kur afati i përfundimit, vlera përfundimtare e projektit dhe cilësia ka devijancë nga afati, vlera fillestare dhe cilësia e parashikuar, njëkohësisht duke argumentuar devijancat.
- c) Projektet e mbyllura përfundimisht, mbi arritjen e rezultateve të synuara për perfituesit nga zbatimi i projektit.
- d) Statusin fizik të projekteve të cilat janë në proces dhe vijojnë në vitin buxhetor pasardhës si dhe duke evidentuar veçmas ato projekte që janë në vonesë realizimi.

SHTOJCA 1 (F-1)

F – 1 Formulari i Prezantimit të Projekt-Idesë (FPPI)

1. Personat e Kontaktit

| | | | |
|---|--|----------------------------------|--|
| Emri i propozuesit të projektit | | Firma e propozuesit të Projektit | |
| Të dhëna të detajuara për propozuesin e projektit | | | |
| Institucioni Buxhetor / Ministria/grupi/sektori | | Vendndodhja e Projektit | |

2. Identifikimi i Idesë së Investimit

| | |
|---|---|
| Projekt-Ideja | |
| Emri i Programit | |
| Problemet për t'u adresuar | <i>Një përshkrim i gjendjes aktuale, përfshirë, ndryshimet klimatike, analizës gjinore të situatës, dhe problemet siç perceptohen nga burrat dhe gratë përfitues/e direkt/e të investimit. Duhet të kihet parasysh që përshkrimi i problemeve aktuale dhe nevojave për të ardhmen të përmbajë sa më shumë të jetë e mundur të dhëna sasiore dhe cilësore të ndara sipas gjinisë dhe disagregimeve të tjera të mundshme (demografia, moshë, përkatësia etnike, etj).</i> |
| Qëllimet dhe objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të arrihen | <i>Të argumentohet përputhja e investimit me objektivat e programit në të cilin bën pjesë ky projekt. Ndërlidhja e projekt propozimit me:</i> 1. Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Strategjinë Sektoriale 2. Deklaratën e prioritetëve të Qeverisë <i>(të jepen konkretisht lidhjet me dokumentet e mësipërme)</i> |

3. Kostot e Projektit të Investimit

| | |
|-------------------------------------|--|
| Kosto Totale e Projektit (000/lekë) | |
|-------------------------------------|--|

4. Autorizuesit / Hapat e aprovimit të projekt-idesë

| | Emri | Nënshkrimi | Data | Qëllimi i rishikimit <i>Statusi i Projektit-Idesë</i> |
|--|------|------------|------|--|
| Drejtuesi i Programit në Institucionin Buxhetor (IB) | | | | Aprovimi / refuzimi për t'u shqyrtuar më tej |
| Komente nga Drejtuesi i Programit (n.q.s. ka) | | | | |
| Sekretari i Përgjithshëm | | | | Konfirmimi/refuzimi i aprovimit të projekt-idesë |
| Komente nga Sekretari i Përgjithshëm (n.q.s. ka) | | | | |

SHTOJCA 2 (F-2)

F2 - Formulari i Konceptimit të Investimit për Shpenzime Administrative Kapitale (FKISHAK)

Cilësia e konceptimit të projektit është përgjegjësia përfundimtare e propozuesve. Kur një FKISHAK është duke u përgatitur dhe përpara dorëzimit të tij për vlerësim në ministrinë e përgjegjëse për financat, propozuesi duhet të marrë masa për të siguruar që cilësia e FKISHAK është mjaft e mirë për të pasur shanset më të mira të mundshme për tu pranuar. Tabela më poshtë është Formulari i Konceptimit të Investimit për Shpenzime Administrative Kapitale me udhëzime për propozuesit (*jeshile e errët*) dhe vlerësuesit (udhëzime për kontrollin e cilësisë). Për të gjitha pyetjet projekti duhet të marrë “kalim”, përndryshe projekti do të kthehet për zhvillim të mëtejshëm.

| 1. Detajet e kontaktit | |
|--|--|
| Institucioni buxhetor | |
| Departamenti | |
| Emri dhe pozicioni i propozuesit të projektit | |
| Detajet e kontaktit të propozuesit të projektit <i>(telefon, email)</i> | |
| Personi i Kontaktit për Buxhetin dhe Financat | |
| Detajet e kontaktit të buxhetit dhe financave | |

| 2. Identifikimi i investimit | |
|---|--|
| Ministria/grupi/sektori (Institucioni buxhetor) | |
| Emri i programit | |
| Kodi i grupit | |
| Kodi i projektit | |
| Numri i identifikimit nga DPIM | |
| Titulli i Projektit | <i>Sigurohuni që të përdorni plotësisht titullin e saktë të Projektit. Pasi një projekt të jetë pranuar, titulli i treguar në këtë kuti do të bëhet emri i tij zyrtar.</i> |
| | |

| | | | |
|--|---|---|---|
| Vendndodhja e projektit | <i>Ju lutemi specifikoni vendndodhjen e projektit duke dhënë emrin e rajonit/qytetit dhe adresën, jepni të dhëna gjeohapësinore ose futni një hartë, nëse është e mundur.</i> | | |
| Statusi i projektit | I ri <input type="checkbox"/> | Lloji i investimit | Shpenzime Administrative <input type="checkbox"/> |
| | Në vazhdim <input type="checkbox"/> | | Emergjencia <input type="checkbox"/> |
| | | | Shpenzime për Projekte Investimesh <input type="checkbox"/> |
| Data e parashikuar e fillimit të projektit <i>(muaj, vit)</i> | | Data e parashikuar e përfundimit të projektit <i>(muaj, vit)</i> | |

| 3. Arsyetimi i Investimeve | |
|--|--|
| <p>3.1. Çështjet aktuale që duhen trajtuar/ Arsyetimi i nevojës për investime <i>Përshkrimi i situatës aktuale, përfshirë analizën gjinore të situatës si dhe problemeve të perceptuara nga gratë dhe burrat përfituesit direkt të investimeve. Përshkrimi i çështjeve aktuale dhe nevojave të ardhshme duhet të përmbajë sa më shumë të dhëna sasiore dhe cilësore të ndara sipas gjinisë, dhe disagregimeve të tjera të mundshme (demografia, mosha, përkatësia etnike, etj). Tregoni problemin kryesor që projekti duhet të zgjidhë, shkaqet dhe efektet specifike të problemit kryesor. Jepni arsyetimin për projektin dhe listoni arsyet për të investuar në projekt.</i></p> | <p>Kontrolli i cilësisë</p> <p>Dështon = Dështon për të përshkruar problemin ose problemi i përshkruar nuk konsiderohet i rëndësishëm</p> <p>Jo i qartë = Nuk ka informacion numerik dhe/ose cilësor të mjaftueshëm për shkallën e problemit</p> <p>Kalon = Problemi dhe shkaqet e tij shpjegohen plotësisht me disa dëshmi të shkallës.</p> |

| | |
|---|--|
| <p>3.2. Objektivat dhe synimet e Projektit <i>Objektivi i përgjithshëm (ndikimi) janë përfitimet afatgjata që synon të arrijë investimi. Këto objektiva zakonisht vendosen në nivel Programi. Objektivat specifikojnë pse projekti është i nevojshëm për përfituesit e drejtpërdrejtë të investimit. Tregoni qartë objektivat që propozuesi synon të përmbushë me këtë propozim. Ato duhet të jenë një zgjidhje për problemin e përmendur më parë. Duhet të ketë një objektiv të vetëm parësor të shprehur në jo më shumë se dy ose tre fjali dhe objektiva të mëtejshëm specifike. Vini re se objektivat duhet të jenë specifike, të matshëm, realistë dhe të përcaktuar në kohë.</i></p> | <p>Kontrolli i cilësisë</p> <p>Dështon = Objektivat nuk e zgjidhin problemin kryesor</p> |
| | <p>Jo i qartë = Objektivat e përshkruara zgjidhin problemin pjesërisht</p> <p>Kalon = Objektivat e përshkruar qartë si një zgjidhje për problemin</p> |
| <p>3.3. Përfitimet dhe kostot e projektit <i>Të gjitha projektet kanë ndikime pozitive dhe/ose negative (kosto dhe përfitime) tek përfituesit e synuar të projektit, si dhe krijojnë efekte të jashtme pozitive dhe/ose negative.</i></p> <p><i>Listoni kostot (ndikimi negativ) dhe përfitimet (ndikimi pozitiv) pas zbatimit të suksesshëm të projektit së bashku me përshkrimin e tyre. Ndërsa në shumicën e rasteve zbatimi i Projektit do të sjellë përfitime (kursim në kohë, jetë të shpënuara reduktim i CO2), përmirësimi i situatës së pabarazive gjinore si dhe shëndetit të grave dhe burrave të të gjitha moshave), shumë projekte kanë një formë ndikimi negativ (kosto), më të zakonshmet prej të cilave janë kostot mjedisore dhe rritja e emetimit të CO2¹.</i></p> | <p>Kontrolli i cilësisë</p> <p>Dështon = nuk rendit ndonjë ndikim pozitiv të projektit ose ndikimet negative janë të papranueshme</p> |
| | <p>Jo i qartë = ndikimet pozitive dhe negative janë renditur por nuk shpjegohen qartë</p> <p>Kalon = ndikimet pozitive dhe negative shpjegohen qartë dhe duken të pranueshme</p> |

¹Tregimi nëse projekti do të kontribuojë (direkt ose indirekt) në reduktimin ose rritjen e emetimeve të GHG si dhe ndikimi i tyre në jetët e burrave dhe grave të të gjitha moshave është i detyrueshëm

3.4. Përshkrimi i përgjithshëm i qëllimit të projektit

Ju lutemi jepni një përshkrim të detajuar të alternativës së zgjedhur dhe përcaktoni qëllimin e Projektit (Informacioni duhet të jetë sa më cilësor dhe sasior të jetë e mundur i ndarë sipas gjinisë dhe disagregimeve të tjera demografike, moshës, etnisë, etj, kur është e mundur), për shembull: 12 km rrugë me 2 korsi që kalon midis [qytetit] dhe [qytetit] ose Ndërtimi i shkollës së re për 500 studentë në [qytet]], tregoni të gjithë komponentët e Projektit, p.sh. përgatitja e dokumentacionit, punimet e ndërtimit etj.

Nënvizoni masat e nevojshme të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike ose tregoni se çfarë hapash do të ndërmerren për ta bërë projektin elastik ndaj rreziqeve të parashikuara nga ndryshimet klimatike në përputhje me analizën e rrezikut të paraqitur më tej në FKPI. Përfitimi i infrastrukturës më elastike duhet të jetë reduktimi i kostos së ciklit jetësor të aseteve dhe i humbjeve sociale/ekonomike nga ndërprerja e shërbimeve.

Tregoni se si qëllimi i projektit mori parasysh nevojën për të zbutur ndikimin e projektit në ndryshimet klimatike si dhe në përmirësimin e jetesës së burrave dhe grave të të gjitha moshave që preken drejtëpërsëdrejti nga zbatimi i tij.

Kontrolli i cilësisë

Dështon = është e paqartë se cili është qëllimi i projektit ose duket të jetë fragment i projektit më të madh dhe i pavarur nuk do të sjellë përfitimet e pritura

Jo i qartë = qëllimi i projektit është përshkruar, por komponentët e përfshirë duket të jenë të pamjaftueshëm për zbatimin e suksesshëm të projektit, nevojitet shpjegim i mëtejshëm. Rreziku i ndryshimeve klimatike dhe pasojave në jetën e grave dhe burrave të të gjitha moshave që preken drejtëpërsëdrejti nga projekti nuk është marrë parasysh

Kalon = Qëllimi i Projektit është i përshkruar mirë dhe përfshin të gjithë komponentët e projektit të nevojshëm për zbatimin e suksesshëm të projektit, duke marrë parasysh çështjet e ndryshimit të klimës (në lidhje me rrezikun e identifikuar të ndryshimeve klimatike) dhe pasojave në jetën e grave dhe burrave të të gjitha moshave që preken drejtëpërsëdrejti nga projekti)

| 4. Vlera e Projektit të Investimit (në lekë) | | | | | | | |
|--|---------------------------|-------|-------|-------|--|-----------------------------|---|
| Lloji i shpenzimit | Kostot janë paguar tashmë | 20 __ | 20 __ | 20 __ | Kostoja e investimit në vitet e ardhshme | Kostoja totale e investimit | Kontrolli i cilësisë |
| (a) Dokumentacioni përgatitor | | | | | | | Dështon = Vlerësimi i kostove të projektit bazuar në informacione jo të besueshme dhe nuk përfshin të gjithë fushën e projekteve |
| (b) Studim Fizibiliteti | | | | | | | |
| (c) Blerja e tokës | | | | | | | |
| (d) Shpronësime | | | | | | | Jo i qartë = Vlerësimi i kostove të projektit bazuar në burime ndoshta të besueshme, me të gjithë fushën e përfshirë, por kërkon sqarim |
| (e) Ndërtimi | | | | | | | |
| (f) Pajisjet | | | | | | | |
| (g) Supervizimi | | | | | | | Kalon = Vlerësimi i kostos së projekteve bazuar në informacione të besueshme dhe përfshin të gjithë fushën |
| (h) Kolaudimi | | | | | | | |
| (i) Kosto të tjera | | | | | | | |
| (j) Total (a+b+c+d+e+f+g+h+i) | | | | | | | |
| (l) Financimi nga donatorët (kontributi i vlerësuar i donatorit nëse supozohet) | | | | | | | |
| (k) Kostoja neto kapitale (j+l) (kontributi i parashikuar i buxhetit të shtetit për këtë investim) | | | | | | | |
| Komentet | | | | | | | |
| <i>Specifikoni mbi çfarë baze janë vlerësuar kostot e investimit. A përfshijnë kostot e TVSH-së?</i> | | | | | | | |
| <i>Cili është financimi i parashikuar nga donatorët (kredi, subvencionim) dhe nëse është nënshkruar ndonjë marrëveshje me donatorët.</i> | | | | | | | |
| <i>Nëse projekti është në vazhdim, përshkruani se çfarë është bërë tani</i> | | | | | | | |

| 5. Kostot operative dhe të ardhurat e vlerësuara pas zbatimit të projektit (në lekë) | | | | |
|---|---|--------------------------|---------------------------|---|
| 5.1. Kostot e vlerësuara operative vjetore (në Lekë) pas zbatimit të projektit | <i>Specifikoni nivelin e kostove shtesë operative për shkak të zbatimit të projektit pas përfundimit të tij. Vini re se kostot duhet të paraqiten si shtesë të skenarit "pa projekt". Nëse ka kursime të parashikuara, ju lutemi paraqisni ato si kosto me minus (ulje të kostove).</i> | | | Kontrolli i cilësisë Dështon = Vlerësimi i kostove operative dhe të ardhurave nuk është paraqitur Jo i qartë = Vlerësimi i kostove operative dhe të ardhurave është paraqitur por kërkon sqarim Kalon = Vlerësimi i kostove operative dhe të ardhurave të paraqitura dhe komentuar |
| Viti i parë operacional | Viti i dytë operacional | Viti i tretë operacional | Viti i katërt operacional | |
| | | | | |
| Komentet <i>Jepni komente në lidhje me kostot</i> | | | | |
| 5.2. Të ardhurat vjetore (në Lekë) të vlerësuara pas zbatimit të projektit (nëse është e aplikueshme) | <i>Specifikoni nivelin e të ardhurave shtesë për shkak të zbatimit të projektit pas përfundimit të tij. Vini re se kostot duhet të paraqiten si shtesë të skenarit "pa projekt".</i> | | | Kontrolli i cilësisë Dështon = Vlerësimi i kostove operative dhe të ardhurave nuk është paraqitur por kërkon sqarim Jo i qartë = Vlerësimi i kostove operative dhe të ardhurave është paraqitur por kërkon sqarim Kalon = Vlerësimi i kostove operative dhe të ardhurave të paraqitura dhe komentuar |
| Viti i parë operacional | Viti i dytë operacional | Viti i tretë operacional | Viti i katërt operacional | |
| | | | | |
| Komentet <i>Jepni komente në lidhje me të ardhurat</i> | | | | |

| 6. Menaxhimi i projektit, parakushtet dhe rreziqet | |
|--|---|
| 6.1. Parakushtet dhe rreziqet e zbatimit të projektit me veprime të planifikuara për të eliminuar/minimizuar ndikimin e tyre <i>Shumë gjëra mund dhe të shkojnë keq gjatë përgatitjes dhe zbatimit të projekteve. Zakonisht, këto rezultojnë ose në një vonesë të përfundimit të Projektit ose në një rritje të kostove të vlerësuara. Prandaj është e nevojshme të identifikohet dhe të përshkruhet këtu çdo rrezik i mundshëm që mund të parandalojë zbatimin e suksesshëm të projektit ose të pengojë performancën e tij operacionale (p.sh. rreziku i projektimit, rreziku politik, luhatjet e këmbimit valutor, ndryshimet klimatike, probleme sociale të burrave dhe grave që preken nga projekt etj.)</i> <i>a. Identifikoni faktorët e jashtëm që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të projektit; për rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike, ju lutemi përgjigjuni pyetjeve të dhëna në metodologjinë e vlerësimit të rrezikut klimatik dhe tregoni nivelin e rrezikut të lidhur me ndryshimet klimatike dhe gjinore me një shpjegim të shkurtër;</i> <i>b. Specifikoni nevojën për ndryshime ligjore apo masa rregullatore, të cilat duhet të merren si parakusht për fillimin e projektit investues;</i> | Kontrolli i cilësisë Dështon = Rreziqet duken të paplota ose nuk është ndërmarrë asnjë përpjekje serioze për menaxhimin e rrezikut Jo i qartë = Rreziqet janë të listuara, por masat e menaxhimit të rrezikut duken të paplota ose nuk kanë besueshmëri Kalon = Rreziqet janë renditur dhe masat e menaxhimit të rrezikut duken të besueshme |

7. Vendimmarrësit për miratimin e projektit

| | Emri | Nënshkrimi | Data |
|---|------|------------|------|
| Menaxher i Programit të Institucionit Buxhetor | | | |
| Menaxher i Financave/Buxhetit të Institucionit Buxhetor | | | |
| Menaxhmenti i Institucionit Buxhetor | | | |

SHTOJCA 3 (F-3)

F3 - Formulari i Konceptimit të Projektit të Investimit (FKPI)

Cilësia e konceptimit të projektit është përgjegjësia përfundimtare e propozuesve. Kur një FKPI është duke u përgatitur dhe përpara dorëzimit të tij për vlerësim në ministrinë e përgjegjëse për financat dhe/ose Institucionin përgjegjës për programimin strategjik, propozuesi duhet të marrë masa për të siguruar që cilësia e FKPI-së është mjaft e mirë për të pasur shanset më të mira të mundshme për tu pranuar. Tabela më poshtë është Formulari i Konceptimit të Projektit të Investimit me udhëzime për propozuesit (*jeshile e errët*) dhe vlerësuesit (udhëzime për kontrollin e cilësisë). Për të gjitha pyetjet projekti duhet të marrë “kalim”, përndryshe projekti do të kthehet për zhvillim të mëtejshëm.

| 1. Detajet e kontaktit | |
|---|--|
| Institucioni buxhetor | |
| Departamenti | |
| Emri dhe pozicioni i propozuesit të projektit | |
| Detajet e kontaktit të propozuesit të projektit (<i>telefon, email</i>) | |
| Personi i Kontaktit për Buxhetin dhe Financat | |
| Detajet e kontaktit të buxhetit dhe financave | |

| 2. Identifikimi i investimit | | | |
|---|---|--|---|
| Ministria/grupi/sektori (Institucioni buxhetor) | | | |
| Emri i programit | | | |
| Kodi i grupit | | | |
| Kodi i projektit | | | |
| Numri i identifikimit nga DPIM | | | |
| Titulli i Projektit | <i>Sigurohuni që të përdorni plotësisht titullin e saktë të Projektit. Pasi një projekt të jetë pranuar, titulli i treguar në këtë kuti do të bëhet emri i tij zyrtar.</i> | | |
| Vendndodhja e projektit | <i>Ju lutemi specifikoni vendndodhjen e projektit duke dhënë emrin e rajonit/qytetit dhe adresën, jepni të dhëna gjeohapësinore ose futni një hartë, nëse është e mundur.</i> | | |
| Statusi i projektit | I ri <input type="checkbox"/> | Lloji i investimit | Shpenzime Administrative <input type="checkbox"/> |
| | Në vazhdim <input type="checkbox"/> | | Emergjencia <input type="checkbox"/> |
| | | | Shpenzime për Projekte Investimesh <input type="checkbox"/> |
| Data e parashikuar e fillimit të projektit (<i>muaj, vit</i>) | | Data e parashikuar e përfundimit të projektit (<i>muaj, vit</i>) | |

| 3. Arsyetimi i Investimeve | |
|--|--|
| 3.1. Çështjet aktuale që duhen trajtuar/ Arsyetimi i nevojës për investime <i>Përshkrimi i situatës aktuale përfshirë analizën gjimore të situatës dhe problemeve të perceptuara nga gratë dhe burrat përfitues/e direkt të investimeve. Përshkrimi i çështjeve aktuale dhe nevojave të ardhshme duhet të përmbajë sa më shumë të dhëna sasiore dhe cilësore të ndara sipas gjinisë (dhe disagregimeve të tjera demografike, moshës, etnisë, etj, kur është e mundur). Tregoni problemin kryesor që projekti duhet të zgjidhë dhe shkaqet dhe efektet specifike të problemit kryesor. Jepni arsyetimin për projektin dhe listoni arsyet për të investuar në projekt.</i> | Kontrolli i cilësisë Dështon = Dështon për të përshkruar problemin ose problemi i përshkruar nuk konsiderohet i rëndësishëm Jo i qartë = Nuk ka informacion numerik dhe/ose cilësore të mjaftueshëm për shkallën e problemit Kalon = Problemi dhe shkaqet e tij shpjegohen plotësisht me disa dëshmi të shkallës. |
| 3.2. Objektivat dhe synimet e Projektit <i>Objektivi i përgjithshëm (ndikimi) janë përfitimet afatgjata që synon të arrijë investimi. Këto objektiva zakonisht vendosen në nivel Programi. Objektivat specifikojnë pse projekti është i nevojshëm për përfituesit e drejtpërdrejtë të investimit. Tregoni qartë objektivat që propozuesi synon të përbushë me këtë propozim. Ato duhet të jenë një zgjidhje për problemin e përmendur më parë. Duhet të ketë një objektiv të vetëm parësor të shprehur në jo më shumë se dy ose tre fjali dhe objektiva të mëtejshëm specifike. Vini re se objektivat duhet të jenë specifike, të matshëm, realiste dhe të përcaktuar në kohë.</i> | Kontrolli i cilësisë Dështon = Objektivat nuk e zgjidhin problemin kryesor Jo i qartë = Objektivat e përshkruara zgjidhin problemin pjesërisht Kalon = Objektivat e përshkruar qartë si një zgjidhje për problemin |
| 3.3. Nëse PPP konsiderohet si një opsion prokurimi, ju lutemi paraqisni një arsyetim të qartë pas një arsyetimi të tillë. <i>Nëse propozuesi i projektit mendon se PPP është një mënyrë e mirë për të zbatuar idenë e projektit, duhet të tregohet dhe shpjegohet këtu. Krahasimi fillestar ndërmjet prokurimit tradicional dhe PPP-ve (pro dhe kundër) duhet të paraqitet këtu, nëse është e aplikueshme.</i> | Kontrolli i cilësisë Dështon = Nuk ka përpjekje serioze për të adresuar pyetjen Jo i qartë = Përgjigja e dhënë adreson pyetjen, por arsyetimi për PPP nuk është i mjaftueshëm Kalon = Është e qartë pse sektori publik ose privat ose të dy mund të jenë zbatues i këtij projekt-propozimi |
| 3.4. Rëndësia strategjike e projektit <i>Ju lutemi jepni lidhje specifike me dokumentet e mësipërme dhe provoni se zbatimi i këtij propozimi do të kontribuojë në arrijtjen e qëllimeve strategjike të qeverisë së Shqipërisë, duke përfshirë të paktën:</i> 1. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Strategjia Sektoriale 2. Deklarata e prioriteteve të Qeverisë | Kontrolli i cilësisë Dështon = Nuk u vendos asnjë lidhje ndërmjet projektit dhe Strategjisë/ |

| | | |
|---|---|--|
| | | <p>prioriteteve të qeverisë/ projektit nuk i përmbush objektivat/ prioritetet strategjike</p> <p>Jo i qartë = Është bërë referencë për strategjinë përkatëse/ prioritetet e qeverisë por nuk është dhënë asnjë arsyetim</p> <p>Kalon = Është bërë referencë në Planin ose Strategjinë përkatëse dhe është dhënë një shpjegim i qartë për lidhjen e projektit të propozuar.</p> |
| <p>3.5. Përfitimet dhe kostot e projektit <i>Të gjitha projektet kanë ndikime pozitive dhe/ose negative (kosto dhe përfitime) tek përfituesit e synuar të projektit, si dhe krijojnë efekte të jashtme pozitive dhe/ose negative.</i> <i>Listoni kostot (ndikimi negativ) dhe përfitimet (ndikimi pozitiv) pas zbatimit të suksesshëm të projektit së bashku me përshkrimin e tyre. Ndërsa në shumicën e rasteve zbatimi i Projektit do të sjellë përfitime (kursim në kohë, jetë të shpëtuar, reduktim i CO2), përmirësimi i situatës së pabarazive gjinore si dhe shëndetit të grave dhe burrave të të gjitha moshave), shumë projekte kanë një formë ndikimi negativ (kosto), më të zakonshmet prej të cilave janë kostot mjedisore dhe rritja e emetimit të CO2².</i></p> | | <p>Kontrolli i cilësisë</p> <p>Dështon = nuk rendit ndonjë ndikim pozitiv të projektit ose ndikimet negative janë të papranueshme</p> <p>Jo i qartë = ndikimet pozitive dhe negative janë renditur por nuk shpjegohen qartë</p> <p>Kalon = ndikimet pozitive dhe negative shpjegohen qartë dhe duken të pranueshme</p> |
| <p>4. Përshkrimi i projektit përfshirë alternativat dhe treguesit (të plotësohet vetëm për projekte me rëndësi strategjike)</p> | | |
| <p>4.1. Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara <i>Renditni të gjitha alternativat që janë marrë në konsideratë për arritjen e objektivave të projektit dhe për adresimin e problemit të përshkruar në seksionin 2.1. Përveç alternativave të investimit, nëse është e mundur, ai duhet të përfshijë të gjitha opsionet relevante jo-kapitale që mund të përfshijnë për shembull 'ndërgjegjësimin më të mirë të publikut'.</i> <i>Kundër secilës alternativë, një ose dy fjali duhet të shpjegojnë pse çdo opsion u refuzua. Opsioni i preferuar duhet të identifikohet qartë me një shpjegim se pse preferohet.</i> <i>Opsioni i preferuar duhet të përmbajë të paktën prova bazë për të mbështetur pikëpamjen se duhet të konsiderohet si opsioni më i mirë.</i></p> | | <p>Kontrolli i cilësisë Dështon = Nuk ka opsione të listuara ose të konsideruara</p> <p>Jo i qartë = Opsionet e listuara, por asnjë shpjegim se pse u zgjodh opsioni i preferuar ose të tjerët u refuzuan</p> <p>Kalon = Opsionet janë renditur dhe është e qartë se cila është arsyeja pas opsionit të preferuar</p> |
| <p>Alternativa 1 (Përshkrim i shkurtër)</p> | <p>Përshkrim i shkurtër i alternativës së investimit 1 (nëse identifikohet)</p> | |
| | | |
| <p>Alternativa 2 (Përshkrim i shkurtër)</p> | <p>Përshkrim i shkurtër i alternativës së investimit 2 (nëse identifikohet)</p> | |

²Tregimi nëse projekti do të kontribuojë (direkt ose indirekt) në reduktimin ose rritjen e emetimeve të GHG është i detyrueshëm si dhe ndikimi i tyre në jetën e grave dhe burrave të të gjitha moshave që preken nga projekti.

| | | |
|--|---|--|
| | | |
| Alternativa 3 (Përshkrim i shkurtër) | <i>Përshkrim i shkurtër i alternativës së investimit 3 (nëse identifikohet)</i> | |
| | | |
| Alternativa e zgjedhur (Përshkrim i shkurtër) | <i>Arsyet për zgjedhjen e alternativës së preferuar të investimit</i> | |
| | | |
| <p>4.2. Përshkrimi i përgjithshëm i qëllimit të projektit</p> <p><i>Ju lutemi jepni një përshkrim të detajuar të alternativës së zgjedhur dhe përcaktoni qëllimin e Projektit (Informacioni duhet të jetë sa më cilësor dhe sasior të jetë e mundur i ndarë sipas gjinisë dhe disagregimeve të tjera demografike, moshës, etnisë, etj, kur është e mundur), për shembull: 12 km rrugë me 2 korsi që kalon midis [qytetit] dhe [qytetit] ose Ndërtimi i shkollës së re për 500 studentë në [qytet]], tregoni të gjithë komponentët e Projektit, p.sh. përgatitja e dokumentacionit, punimet e ndërtimit etj.</i></p> <p><i>Nënvizoni masat e nevojshme të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike ose tregoni se çfarë hapash do të ndërmerren për ta bërë projektin elastik ndaj rreziqeve të parashikuara nga ndryshimet klimatike në përputhje me analizën e rrezikut të paraqitur më tej në FKPI. Përfitimi i infrastrukturës më elastike duhet të jetë reduktimi i kostos së ciklit jetësor të asetëve dhe i humbjeve sociale/ekonomike nga ndërprerja e shërbimeve.</i></p> <p><i>Tregoni se si qëllimi i projektit mori parasysh nevojën për të zbutur ndikimin e projektit në ndryshimet klimatike si dhe në përmirësimin e jetesës së burrave dhe grave të të gjitha moshave që preken drejtpërsëdrejti nga zbatimi i tij.</i></p> | | <p>Kontrolli i cilësisë</p> <p>Dështon = është e paqartë se cili është qëllimi i projektit ose duket të jetë fragment i projektit më të madh dhe i pavarur nuk do të sjellë përfitimet e pritura</p> <p>Jo i qartë = qëllimi i projektit është përshkruar, por komponentët e përfshirë duket të jenë të pamjaftueshëm për</p> |

| | |
|--|--|
| | <p>zbatimin e suksesshëm të projektit, nevojitet shpjegim i mëtejshëm. rreziku i ndryshimeve klimatike dhe pasojave në jetën e grave dhe burrave të të gjitha moshave që preken drejtpërsëdrejti nga projekti nuk është marrë parasysh</p> <p>Kalon = Qëllimi i Projektit është i përshkruar mirë dhe përfshin të gjithë komponentët e projektit të nevojshëm për zbatimin e suksesshëm të projektit, duke marrë parasysh çështjet e ndryshimit të klimës (në lidhje me rrezikun e identifikuar të ndryshimeve klimatike) dhe pasojave në jetën e grave dhe burrave të të gjitha moshave që preken drejtpërsëdrejti nga projekti.</p> |
|--|--|

| | | | | | | |
|---|--|--|--------------|-----------------------------|--|---------------|
| <p>4.3. Treguesit e produktit <i>Ju lutemi përmendni deri në tre (3) tregues të produktit të Strategjisë Kombëtare dhe/ose Sektoriale (titulli/përshkrimi) mbi të cilët projekti do të kontribuojë për arritjen e tij</i></p> <p><i>Ju lutemi përcaktoni dokumentin p.sh. SKZHI ose Strategjia Sektoriale dhe objektivi dhe kapitulli specifik i Dokumentit Strategjik.</i></p> | Treguesi 1 | | | Kontrolli i cilësisë | | |
| | Referenca e dokumentit | | | | | |
| | | | Vlera | | Njësia | |
| | Vlera aktuale e treguesit | | | | | |
| | Vlera e synuar e treguesit të projektit | | | | | |
| | Vlera e synuar e treguesit të Strategjisë Kombëtare dhe/ose Sektoriale | | | | | |
| | Treguesi 2 | | | | Dështon = nuk ka tregues të produktit të paraqitur Jo i qartë = Rezultatet e listuara por jo në përputhje me Strategjitë Kombëtare / Sektoriale Kalon = Rezultatet e renditura në përputhje me Strategjitë Kombëtare ose Sektoriale | |
| | Referenca e dokumentit | | | | | |
| | | | Vlera | | | Njësia |
| | Vlera aktuale e treguesit | | | | | |
| | Vlera e synuar e treguesit të projektit | | | | | |
| | Vlera e synuar e treguesit të Strategjisë Kombëtare dhe/ose Sektoriale | | | | | |
| | Treguesi 3 | | | | | |
| | Referenca e dokumentit | | | | | |
| | | | Vlera | | | Njësia |
| Vlera aktuale e treguesit | | | | | | |
| Vlera e synuar e treguesit të projektit | | | | | | |
| Vlera e synuar e treguesit të Strategjisë Kombëtare dhe/ose Sektoriale | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|--|--|--------------|---------------|---|--|
| <p>4.4. Treguesit e rezultateve <i>Ju lutemi përmendni deri në dy (2) Treguesit e Rezultateve të Strategjisë Kombëtare dhe/ose Sektoriale (titulli/përshkrimi) mbi të cilët projekti do të kontribuojë për arritjen e tij</i></p> <p><i>Ju lutemi përcaktoni dokumentin p.sh. SKZHI ose Strategjia Sektoriale dhe objektivi dhe kapitulli specifik i Dokumentit Strategjik.</i></p> | Treguesi 1 | | | | <p>Kontrolli i cilësisë</p> <p>Dështon = nuk ka tregues rezultati të paraqitur</p> <p>Jo i qartë = Rezultatet e listuara por jo në përputhje me Strategjitë Kombëtare/Sektoriale</p> <p>Kalon = Rezultatet e renditura në përputhje me Strategjitë Kombëtare ose Sektoriale</p> | |
| | Referenca e dokumentit | | | | | |
| | | | Vlera | Njësia | | |
| | Vlera aktuale e treguesit | | | | | |
| | Vlera e synuar e treguesit të projektit | | | | | |
| | Vlera e synuar e treguesit të Strategjisë Kombëtare dhe/ose Sektoriale | | | | | |
| | Treguesi 2 | | | | | |
| | Referenca e dokumentit | | | | | |
| | | | Vlera | Njësia | | |
| | Vlera aktuale e treguesit | | | | | |
| | Vlera e synuar e treguesit të projektit | | | | | |
| | Vlera e synuar e treguesit të Strategjisë Kombëtare dhe/ose Sektoriale | | | | | |

| | | | | | |
|---|--|--|--|--|--|
| <p>4.5. Numri i Vendeve të Punës <i>Ju lutemi specifikoni numrin e vendeve të punës (Ekuivalenti me kohë të plotë - FTE) gjatë ndërtimit të projektit (kostoja totale e vlerësuar e punës e investimit pjesëtuar me pagën bazë vjetore). Kostoja totale e punës vlerësohet bazuar në përqindjen mesatare të përqindjes së kostos së punës në koston totale të investimit të projekteve të mëparshme të ngjashme.</i></p> <p><i>Ju lutemi specifikoni numrin e vendeve të reja të punës (Ekuivalenti me kohë të plotë - FTE) gjatë funksionimit të plotë të projektit (FTE të paktën për 5 vjet).</i></p> <p><i>Ju lutemi llogaritni koston e investimit për një pozicion të ri pune (FTE) gjatë operacionit. Formula: Buxheti i projektit / pozicionet e reja të punës gjatë operacionit (njësia: lekë)</i></p> | Numri i vendeve të punës gjatë ndërtimit të projektit | | | <p>Kontrolli i cilësisë</p> <p>Dështon = nuk ka punë të reja të paraqitura</p> <p>Jo i qartë = paraqiten punë të reja, por ka dyshime të forta për besueshmërinë e të dhënave</p> <p>Kalom = vendet e reja të punës të paraqitura dhe kostoja e Investimit për pozicion të ri pune gjatë operacionit të llogaritur</p> | |
| | Punë ekuivalente me kohë të plotë - në total | | | | |
| | Punë ekuivalente me kohë të plotë - Gra | | | | |
| | Punë ekuivalente me kohë të plotë - Burra | | | | |
| | Numri i vendeve të reja të punës gjatë funksionimit të plotë të projektit | | | | |
| | Punë ekuivalente me kohë të plotë - në total | | | | |
| | Punë ekuivalente me kohë të plotë - Gra | | | | |
| | Punë ekuivalente me kohë të plotë - Burra | | | | |
| | Kostoja e investimit për një pozicion të ri pune gjatë operacionit | | | | |

| 5. Vlera e Projektit të Investimit (në lekë) | | | | | | | |
|--|---------------------------|-------|-------|-------|--|-----------------------------|---|
| Lloji i shpenzimit | Kostot janë paguar tashmë | 20 __ | 20 __ | 20 __ | Kostoja e investimit në vitet e ardhshme | Kostoja totale e investimit | Kontrolli i cilësisë Dështon = Vlerësimi i kostove të projektit bazuar në informacione jo të besueshme dhe nuk përfshin të gjithë fushën e projekteve Jo i qartë = Vlerësimi i kostove të projektit bazuar në burime ndoshta të besueshme, me të gjithë fushën e përfshirë, por kërkon sqarim Kalon = Vlerësimi i kostos së projekteve bazuar në informacione të besueshme dhe përfshin të gjithë fushën |
| (a) Dokumentacioni përgatitor | | | | | | | |
| (b) Studim Fizibiliteti | | | | | | | |
| (c) Blerja e tokës | | | | | | | |
| (d) Shpronësime | | | | | | | |
| (e) Ndërtimi | | | | | | | |
| (f) Pajisjet | | | | | | | |
| (g) Supervizimi | | | | | | | |
| (h) Kolaudimi | | | | | | | |
| (i) Kosto të tjera | | | | | | | |
| (j) Total (a+b+c+d+e+f+g+h+i) | | | | | | | |
| (l) Financimi nga donatorët <i>(kontributi i vlerësuar i donatorit nëse supozohet)</i> | | | | | | | |
| (k) Kostoja neto kapitale (j+l) <i>(kontributi i parashikuar i buxhetit të shtetit për këtë investim)</i> | | | | | | | |
| Komentet | | | | | | | |
| <i>Specifikoni mbi çfarë baze janë vlerësuar kostot e investimit. A përfshijnë kostot e TVSH-së?</i> | | | | | | | |
| <i>Cili është financimi i parashikuar nga donatorët (kredi, subvencionim) dhe nëse është nënshkruar ndonjë marrëveshje me donatorët.</i> | | | | | | | |
| <i>Nëse projekti është në vazhdim, përshkruani se çfarë është bërë tani</i> | | | | | | | |

| 6. Kostot operative dhe të ardhurat e vlerësuara pas zbatimit të projektit (në lekë) | | | | |
|--|---|--------------------------|---------------------------|--|
| 6.1. Kostot e vlerësuara operative vjetore (në Lekë) pas zbatimit të projektit | <i>Specifikoni nivelin e kostove shitesë operative për shkak të zbatimit të projektit pas përfundimit të tij. Vini re se kostot duhet të paraqiten si shitesë të skenarit "pa projekt". Nëse ka kursime të parashikuara, ju lutemi paraqisni ato si kosto me minus (ulje të kostove).</i> | | | Kontrolli i cilësisë Dështon = Vlerësimi i kostove operative dhe të ardhurave nuk është paraqitur Jo i qartë = Vlerësimi i kostove operative dhe të ardhurave është paraqitur por kërkon sqarim Kalon = Vlerësimi i kostove operative dhe të ardhurave të paraqitura dhe komentuara |
| Viti i parë operacional | Viti i dytë operacional | Viti i tretë operacional | Viti i katërt operacional | |
| | | | | |
| Komentet <i>Jepni komente në lidhje me kostot</i> | | | | |
| 6.2. Të ardhurat vjetore (në Lekë) të vlerësuara pas zbatimit të projektit (nëse është e aplikueshme) | <i>Specifikoni nivelin e të ardhurave shitesë për shkak të zbatimit të projektit pas përfundimit të tij. Vini re se kostot duhet të paraqiten si shitesë të skenarit "pa projekt".</i> | | | |
| Viti i parë operacional | Viti i dytë operacional | Viti i tretë operacional | Viti i katërt operacional | |
| | | | | |
| Komentet <i>Jepni komente në lidhje me të ardhurat</i> | | | | |

| 7. Menaxhimi i projektit, parakushtet dhe rreziqet | |
|---|--|
| <p>7.1. Parakushtet dhe rreziqet e zbatimit të projektit me veprime të planifikuara për të eliminuar/minimizuar ndikimin e tyre</p> <p><i>Shumë gjëra mund dhe të shkojnë keq gjatë përgatitjes dhe zbatimit të projekteve. Zakonisht, këto rezultojnë ose në një vonesë të përfundimit të Projektit ose në një rritje të kostove të vlerësuara. Prandaj është e nevojshme të identifikohet dhe të përshkruhet këtu çdo rrezik i mundshëm që mund të parandalojë zbatimin e suksesshëm të projektit ose të pengojë performancën e tij operacionale (p.sh. rreziku i projektimit, rreziku politik, luhatjet e këmbimit valutor, ndryshimet klimatike, probleme sociale të burrave dhe grave që preken nga projekt etj).</i></p> <p><i>a. Identifikoni faktorët e jashtëm që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të projektit; për rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike, ju lutemi përgjigjuni pyetjeve të dhëna në metodologjinë e vlerësimit të rrezikut klimatik dhe tregoni nivelin e rrezikut të lidhur me ndryshimet klimatike dhe gjinore me një shpjegim të shkurtër;</i></p> <p><i>b. Specifikoni nevojën për ndryshime ligjore apo masa rregullatore, të cilat duhet të merren si parakusht për fillimin e projektit investues;</i></p> | Kontrolli i cilësisë Dështon = Rreziqet duken të paplota ose nuk është ndërmarrë asnjë përpjekje serioze për menaxhimin e rrezikut Jo i qartë = Rreziqet janë të listuara, por masat e menaxhimit të rrezikut duken të paplota ose nuk kanë besueshmëri |

| | |
|--|---|
| | <p>Kalon = Rreziqet janë renditur dhe masat e menaxhimit të rrezikut duken të besueshme</p> |
| <p>7.2. Përmbledhje e marrëveshjeve dhe roleve të institucioneve që do të menaxhojnë projektin</p> <p><i>Përgjigja do të tregojë se si do të menaxhohet Projekti gjatë zbatimit. Tregoni pozicionet/njësitë përgjegjëse për detyrat kryesore gjatë zbatimit duke ofruar informacion bazë për përvojën e tyre. Për më tepër, përgjigja do të qartësojë të njëjtën çështje në lidhje me fazën e funksionimit, duke treguar institucionin/departamentin përgjegjës.</i></p> <p><i>a. Identifikoni fazat/rezultatet e ndërmjetme, nëse ka, dhe përcaktoni afatet e tyre që mund të përdoren për të treguar progresin në zbatimin e projektit.</i></p> <p><i>b. Specifikoni emrin e drejtorisë dhe menaxherit që do të jetë përgjegjës për projektin ose çdo institucion tjetër që do të krijohet për zbatimin/menaxhimin e projektit.</i></p> | <p>Kontrolli i cilësisë</p> <p>Dështon = Mungesa e burimeve për zbatimin e Projektit ose/dhe indikacioni i mungesës së përgjegjësisë në fazën e operimit</p> <p>Jo i qartë = Burime të pamjaftueshme për zbatimin e projektit ose/dhe tregues të papërshtatshëm të përgjegjësisë në fazën e operimit</p> |
| | <p>Kalon = Burimet për zbatimin e projektit ose/dhe treguesit e përgjegjësisë në fazën e funksionimit të përshkruara mirë dhe të mjaftueshme</p> |

| 8. Dokumentacioni në dispozicion në lidhje me projektin | | | | |
|--|--------------------------|--------------------------|--------------------------|---|
| Lloji i dokumentit | Gati dhe miratuar | Në proces | Nuk ka filluar | Vërejtje |
| Dokumentet e kërkuara sipas Legjislacionit Kombëtar | | | | <i>Ju lutemi jepni informacion në lidhje me datën e përfundimit dhe burimin</i> |
| Idea konceptuale | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| Studimi paraprak i fizibilitetit | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| Dizajni konceptual | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| Studim fizibiliteti + CBA | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| Studimi i VNM-së (nëse nevojitet) | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| Dokumentet e vlefshme të planifikimit hapësinor | | | | |
| a) Plani Hapësinor me Qëllim të Veçantë | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| b) Plani i detajuar hapësinor | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| c) Studimi i vendndodhjes në nivel shtetëror | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |

| 8. Dokumentacioni në dispozicion në lidhje me projektin | | | | |
|--|--------------------------|--------------------------|--------------------------|--|
| Lloji i dokumentit | Gati dhe miratuar | Në proces | Nuk ka filluar | Vërejtje |
| d) Plani zhvillimor hapësinor-urban i vetëqeverisjes lokale | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| e) Plani i detajuar i zhvillimit urban | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| f) Projektimi i zhvillimit urban | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| g) Studimi i vendndodhjes në nivel lokal | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| Pronësia e tokës e zgjidhur | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| Projektim paraprak | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| Dizajni kryesor/dizajn i detajuar | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| Dokumentacioni i tenderit | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> Libri i verdhë FIDIC <input type="checkbox"/> Libri i kuq FIDIC <input type="checkbox"/> Të tjera |
| Lejet e ndërtimit dhe të tjera | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| Kontrata e ndërtimit është nënshkruar | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | |
| Dokumente të tjera të kërkuara Ju lutemi përcaktoni: | | | | |
| Dokumentet e kërkuara nga palët ndërkombëtare të interesit (Donatorët, IFN-të) | | | | |
| VNMS | | | | |
| Dokumente të tjera të kërkuara <i>Nëse është tjetër, ju lutemi specifikoni këtu</i> | | | | |

| 9. Vendimmarrësit për miratimin e projektit | | | |
|---|------|------------|------|
| | Emri | Nënshkrimi | Data |
| Menaxher i Programit të Institucionit Buxhetor | | | |
| Menaxher i Financave/Buxhetit të Institucionit Buxhetor | | | |
| Menaxhmenti i Institucionit Buxhetor | | | |

SHTOJCA 4

Studimi i Fisibilitetit

Dokumenti i Studimit të Fisibilitetit duhet të përgatitet për të gjitha propozimet për projektet e reja të investimeve të cilat përmbushin kriteret për t'u klasifikuar si projekte me rëndësi strategjike, sipas kriterëve të Tabelës 1 në Aneksin 1 dhe vlerës kufi të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës të financave.

Cilësia e konceptimit të Studimit të Fisibilitetit të projektit është përgjegjësia përfundimtare e propozuesve. Kur një studim fisibiliteti është duke u përgatitur dhe përpara dorëzimit të tij për vlerësim në ministrinë e përgjegjëse për financat dhe Institucionin përgjegjës për programimin strategjik, propozuesi duhet të marrë masa për të siguruar që cilësia e studimit të fisibilitetit është mjaft e lartë për të pasur shanset e mundshme që projekti i investimit të maturohet dhe rankohet sa më mirë në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, duke i hapur rrugën për tu përfshirë në PBA apo Buxhetin Vjetor në përputhje me hapësirën fiskale.

Përmbajtja e dokumentit të studimit të fisibilitetit dhe mënyra e përgatitjes të këtij informacioni bëhet sipas udhëzimit të mëposhtëm.

¹ Shtojca 4 ndryshohet me VKM nr. 70, datë 14.2.2024 si vijon:

- në paragrafin e dytë, pas togfjalëshit "**cilësia e konceptimit**", shtohen fjalët "**dhe përmbajtjes**"

- Pas paragrafit të tretë shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Bazuar në natyrën e projektit, institucioni propozues, duke argumentuar, mund të vlerësojë si të paaplikueshme një apo disa seksione të udhëzimit të mëposhtëm."

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje

1. Përmbledhja ekzekutive

2. Analiza e kontekstit ekzistues

- 2.1. Rishikimi i kontekstit social dhe ekonomik
- 2.2. Politika dhe strategjia e qeverisë/masterplani për sektorin/nësektorin
- 2.3. Rolet dhe përgjegjësitë në sektor/nësektor
- 2.4. Analiza e kapaciteteve Institucionale

3. Nevojat dhe objektivat e projektit

- 3.1. Analiza e nevojave dhe identifikimi i përdoruesve të synuar
- 3.2. Objektivat e projektit me treguesit

4. Analiza e kërkesës

5. Analiza e opsioneve

6. Studimet teknike

- 6.1. Sondazhet në terren
- 6.2. Rishikimi i çështjeve të planifikimit hapësinor
- 6.3. Marrja e tokës
- 6.4. Projekti teknik paraprak

7. Objekti i projektit përfundimtar

8. Kostot financiare të projektit dhe plani i zbatimit të projektit

- 8.1. Vlerësimi i kostove financiare të projektit
- 8.2. Plani i zbatimit të projektit

9. Analiza financiare

- 9.1. Metodatat dhe supozimet
- 9.2. Llogaritjet e kostove financiare të investimeve, kostove operative dhe të ardhurave gjatë kohëzgjatjes së projektit
- 9.3. Financimi i projektit
- 9.4. Përballueshmëria e buxhetit
- 9.5. Analiza financiare e fluksit monetar

10. Analiza ekonomike

- 10.1. Metodatat dhe supozimet
- 10.2. Vlerësimi i kostove dhe përfitimeve, duke përfshirë emetimet e gazeve serrë (GHG).
- 10.3. Llogaritja e efekteve që nuk kapen nga vlerësimi ekonomik
- 10.4. Analiza e kostos - përfitimit dhe performanca ekonomike

11. Analiza e vlerës për para për partneritetet publike private

- 11.1. Qasja metodologjike
- 11.2. Analiza cilësore VFM
- 11.3. Analiza sasiore VFM

12. Ndikimet mjedisore dhe sociale

- 12.1. Ndikimi në mjedis, duke marrë parasysh përshtatjen me dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike
- 12.2. Ndikimi social

13. Zbatimi dhe qëndrueshmëria operative

- 13.1. Aftësitë e subjekteve zbatuese dhe operuese
- 13.2. Pasqyrë e përgjithshme e masave të menaxhimit të projektit

14. Analiza e riskut dhe sensitivitetit

- 14.1. Burimet kryesore të riskut dhe masat e reduktimit të ndikimeve të tyre të mundshme
- 14.2. Vlerësimi i riskut nga ndryshimet klimatike me masa reduktuese
- 14.3. Plani i menaxhimit të riskut
- 14.4. Analiza esensivitetit

15. Konkluzione mbi fizibilitetin e projektit

Fjalori

Hyrje

Në këto udhëzime për përgatitjen e studimit të fizibilitetit jepen këshilla për Njësitë e Qeverisjes Qendrore, mbi pritshmëritë në lidhje me përbajtjen e studimeve të fizibilitetit, të cilat përgatiten për qëllimin e vlerësimit të projekteve, në kuadër të procesit të Menaxhimit të Investimeve Publike në Shqipëri. Njësitë e Qeverisjes Qendrore, përgjegjëse për propozimin e projektit, kanë përgjegjësinë e plotë për kryerjen e vlerësimeve të projekteve në Shqipëri. Subjekti përgjegjës për projektin përgatit vlerësimin, së bashku me punën projektuese paraprake dhe studime të tjera mbështetëse, p.sh. studime shtesë të ndikimit mjedisor dhe/ose social. Kjo punë mund të kryhet me punonjësit e brendshëm ose të kontraktohen firma private konsulence, individë ose institucione akademike.

Udhëzimet e mëposhtme pasqyrojnë përbajtjen dhe përshkruajnë kërkesat minimale për një studim fizibiliteti në Shqipëri.

Dokumenti është përgatitur kryesisht bazuar në Udhëzuesin e Komisionit Evropian për Analizën Kosto - Përfitim të Projekteve të Investimeve, 2014 ("Udhëzimet e KE-së")³, i cili zgjeron dhe përditëson botimin e mëparshëm të vitit 2008 dhe jep udhëzime shtesë, specifike për sektorin, p.sh. për transportin, mjedisin, energjinë, brezin e gjerë dhe R&D-në. Në disa raste, autorët i janë referuar gjithashtu Udhëzuesit të Referencës për Investimet Publike të Bankës Botërore, 2020.⁴

Struktura e studimit të fizibilitetit nuk përcakton domosdoshmërisht renditjen e punës: do të ketë reagime dhe përsëritje midis elementeve të ndryshëm të punës dhe studimi përfundimtar i fizibilitetit do të jetë rezultat i këtyre aktiviteteve, jo domosdoshmërisht vijuese.

1. Përmbledhja ekzekutive

Përmbledhja ekzekutive e studimit të fizibilitetit jepet për t'u lejuar vendimmarrësve akses të lehtë në të dhënat përkatëse. Është thelbësore që ky kapitull të plotësohet kur të gjitha seksionet e tjera të jenë finalizuar.

Përbajtja e këtij kapitulli duhet të përbëhet nga informacioni më i rëndësishëm në lidhje me projektin, subjekti i projektit dhe objekti i përgjithshëm i aktiviteteve dhe përfshin të paktën, sa vijon:

- Titullin e projektit;
- Sektorin e projektit;
- Vendndodhjen e projektit;
- Deklaratën e problemit/mundësisë që Projekti do të zgjidhë/trajtojë;
- Objektivat e projektit;
- Përshkrimin e një zone të ndikuar nga projekti dhe rezultatet e analizës së kërkesës;

³ https://ec.europa.eu/regional_policy/sources/docgener/studies/pdf/cba_guide.pdf

⁴Kim, Jay-Hyung, Jonas Arp Fallov, dhe Simon Groom. 2020. Udhëzues referues për menaxhimin e investimeve publike. Zhvillimi ndërkombëtar në praktikë. Uashington, DC: Banka Botërore.

- Përshkrimin e objektit të projektit dhe kostos së investimeve;
- Planin e zbatimit të projektit;
- Përmbledhjen dhe rezultatet e analizave financiare dhe ekonomike;
- Prezantimin e masave të zbatimit;
- Qëndrueshmërinë e projektit;
- Rekomandimet.

2. Analiza e kontekstit ekzistues

2.1. Rishikimi i kontekstit social dhe ekonomik

Hapi i parë i vlerësimit të projektit ka si qëllim të kuptohet konteksti social, ekonomik dhe institucional në të cilin do të zbatohet projekti. Në të vërtetë, mundësia e arritjes së parashikimeve të besueshme të përfitimeve dhe kostove shpesh mbështetet në saktësinë në vlerësimin e kushteve makroekonomike dhe sociale në zonën e ndikimit të projektit. Në varësi të projektit, kufijtë e kontekstit përkatës të kësaj analize, p.sh. lokale, kombëtare ose ndërkomëtare, duhet të identifikohen rast pas rasti. Një analizë e thellë e kontekstit social-ekonomik është gjithashtu e dobishme për kryerjen e analizës së kërkesës.

Në këtë kapitull të studimit të fizibilitetit do të jepet informacion i përgjithshëm mbi rajonin përkatës në të cilin do të zbatohet projekti (*aspektet territoriale dhe mjedisore, të dhënat bazë demografike, ekonomike, financiare, sociale, etj.*). Ky informacion duhet të jetë i rëndësishëm për objektin e investimeve.

2.2. Politika dhe strategjia e qeverisë/masterplani për sektorin/nësektorin

Kërkohet përshkrimi i një projekti, në kontekstin e përputhshmërisë së tij me politikat ose strategjitë përkatëse të qeverisë. Një përshkrim i tillë duhet të provojë se projekti po ndiqet në interes të plotësimit të nevojave të zhvillimit ekonomik ose social të kombëtar ose të një zone lokale. Duhet të shtjellohet mënyra se si projekti kontribuon në arritjen e një ose më shumë objektivave të zhvillimit të vendit dhe sektorit.

2.3. Rolet dhe përgjegjësitë në sektor/nësektor

Duhet të jepet një përshkrim i projektit në kuadrin e rregullimeve organizative në sektorin përkatës. Informacioni duhet të paraqesë situatën aktuale të një sektori përkatës në Shqipëri, si dhe të gjithë informacionin që lidhet me sistemin në të cilin do të funksionojë projekti. Ky kapitull duhet t'u përgjigjet kryesisht pyetjeve të mëposhtme:

- Cila është situata aktuale e sektorit (paraqitja dhe analiza e tendencave të fundit, informacion i përgjithshëm i sektorit) në të cilin do të operojë projekti?
- Cila është situata, si dhe struktura organizative e sistemit, në të cilin do të operojë projekti?

2.4. Analiza e kapaciteteve institucionale

Kapaciteti institucional i referohet të gjitha rregullimeve institucionale të nevojshme për zbatimin dhe funksionimin e projektit [p.sh., krijimi i një Njësie për Zbatimin e Projektit (NjZP)] duke përfshirë çështjet ligjore dhe kontraktuale.

Në këtë seksion duhet të jepet një prezantim i zgjidhjeve të mundshme institucionale dhe të tregohet opsioni më efektiv, me arsyetim.

Kur pronari i infrastrukturës dhe operatori i saj janë të ndryshëm, duhet të jepet një përshkrim mbi pronarin dhe mbi kompaninë ose agjencinë operuese që do të menaxhojë infrastrukturën (nëse dihet). Kjo duhet të përfshijë statusin ligjor të subjektit operues, kriteret e përdorura për përzgjedhjen e tij dhe marrëveshjet kontraktuale të parashikuara ndërmjet partnerëve, duke përfshirë mekanizmat e financimit (p.sh., mbledhjen e tarifave/pagesave të shërbimit, praninë e subvencioneve qeveritare).

3. Nevojat dhe objektivat e projektit

3.1. Analiza e nevojave dhe identifikimi i përdoruesve të synuar

Kërkohej një përshkrim i kushteve që krijojnë nevojën për të zbatuar projektin, d.m.th., arsyetimin e projektit.

Studimi i fizibilitetit duhet të shpjegojë qartë arsyen përse projekti është i nevojshëm, duke identifikuar problemet (ose mundësitë) që do të trajtohen nga projekti. Problemet e identifikuar duhet të përshkruhen në lidhje me përfituesit e projektit dhe nëse është e aplikueshme të mbështeten me të dhëna përkatëse. Përmbytja e këtij seksioni duhet të identifikojë qartë dhe të dallojë përdoruesit (përfituesit) e synuar, sipas llojit (p.sh., shoferë, fëmijë shkolle, familje etj.).

3.2. Objektivat e projektit me treguesit

Pika fillestare për kryerjen e analizave në lidhje me legjitimitetin e zbatimit të aktiviteteve investuese dhe qëndrueshmërinë e tyre ekonomike është përcaktimi i objektivave të projektit. Objektivat e projektit duhet të përcaktohen mbi bazën e një analize të nevojave të mjedisit social dhe ekonomik në lidhje me shkallën e projektit.

Objektivat duhet të jenë 'SMART' - që do të thotë specifike, të matshme, të arritshme, realiste dhe të kufizuara në kohë. Kjo është për të mundësuar monitorimin e projektit gjatë kohëzgjatjes së tij, për të vlerësuar nëse dhe në çfarë mase ai po i arrin objektivat e tij dhe më vonë për të mundësuar vlerësimin e projektit për të parë në çfarë shkalle projekti ka qenë i suksesshëm ose jo.

Objektivat e matshëm të Projektit duhet të pasqyrohen në outpute dhe në treguesit e rezultateve .

Treguesit e outputeve përshkruajnë shpërndarjen e produkteve, p.sh., kilometra rrugë të ndërtuara, kapacitetin e rezervuarëve mbajtës (m³) të krijuar, numrin e shkollave të rinovuara, etj. Arritja e rezultateve të projektit nuk ofron garanci se projekti do të jetë i suksesshëm, por pa arritjen e rezultateve mundësitë për sukses mund të jenë të pakta.

Treguesit e rezultateve shprehen në termat e arritjes së përfitimeve të qëndrueshme për përfituesit e projektit, p.sh., më shumë studentë që hyjnë në universitet ose përdorin njohuritë, si dhe ulja e sëmundshmërisë së fëmijëve nga sëmundje të caktuara.

Në këtë kapitull pritet gjithashtu të jepet një përshkrim i ndikimit të projektit, i cili duhet kuptuar si objektiv i përgjithshëm në të cilin projekti do të kontribuojë, të tilla si rritja e të ardhurave, përmirësimi i standardeve të jetesës, përmirësimi i atraktivitetit për turizmin dhe mbrojtja e burimeve natyrore.

4. Analiza e kërkesës

Analiza e kërkesës identifikon dhe përcakton sasinë e nevojës sociale për investimin e planifikuar. Analiza rigoroze e kërkesës është në qendër të një vlerësimi të mirë të projektit dhe është thelbësore për:

- Projektimin e asetëve kapitale me madhësi të përshtatshme, me kapacitetin e nevojshëm për përdoruesit aktual dhe të ardhshëm;
- Përgatitjen e llogaritjeve të besueshme të kostos;
- Vlerësimin e saktë të përfitimeve të projektit; dhe
- Arritjen e një përfundimi të fortë mbi qëndrueshmërinë ekonomike të projektit.

Zhvillimi i një parashikimi sasior të kërkesës së pritshme për shërbimet e përcaktuara të projektit, duke përfshirë rritjen e pritshme të kësaj kërkesë gjatë kohëzgjatjes së projektit, është thelbësor gjatë vlerësimit të projektit. Në varësi të natyrës së projektit, këto parashikime mund të mbulojnë elemente të tilla si regjistrimin në shkollë, ngarkesën në spitale, trafikun rrugor, konsumin e ujit dhe prodhimin e mbetjeve të ngurta.

Kërkesa ndikohet nga një numër faktorësh të cilët, në varësi të rëndësisë së tyre, mund të duhet të merren parasysh kur bëhen parashikime. Këtu përfshihet:

- Informacioni mbi rritjen ekonomike;
- Ndryshimet e të ardhurave midis përdoruesve potencialë të synuar;
- Ndryshimi demografik – rritja ose rënia natyrore e popullsisë dhe të grupeve të ndryshme brenda saj, migrimi brenda ose jashtë zonës së projektit;
- Zhvillimet e reja të industrisë, biznesit ose bujqësisë në zonën e projektit;
- Kostoja e shërbimeve të ofruara (edhe nëse janë falas, mund të ketë kosto të përfshira në aksesin e shërbimeve);
- Ndryshimi teknologjik afatgjatë dhe ndryshimet në preferencat e publikut.

Niveli i detajeve në parashikimet e kërkesës mund të ndryshojë në varësi të shkallës së projektit dhe masës për të cilën ai është inovativ. Për projektet madhore ose shumë inovative, analiza e kërkesës pritet të jetë shumë e detajuar, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave parësore nëpërmjet sondazheve dhe përdorimin e analizave ekonometrike dhe, aty ku është e zbatueshme, teknikave të modelimit. Për projekte të drejtpërdrejta dhe me vlerë më të ulët, qasja mund të jetë më e thjeshtë, bazuar në analizën inteligjente të tendencës. Megjithatë, thjesht ekstrapolimi i tendencave aktuale pa diskutim nuk është i pranueshëm. Tendencat duhet të shqyrtohen në mënyrë kritike, për të siguruar që nuk do të ketë ndryshime të rëndësishme në faktorët themelorë gjatë kohëzgjatjes së projektit. Cilado qasje që përdoret për përgatitjen e kërkesës, është e rëndësishme të paraqiten dëshmi historike të tendencave të mëparshme, ku kjo ekziston, për të vendosur parashikimin në kontekst.

Për shkak të ndryshimeve në nxitësit themelorë të kërkesës, parashikimet më të sakta do të merren duke projektuar veçmas kërkesën për grupe të ndryshme përdoruesish (dhe më pas duke i kombinuar ato), në vend që të zhvillohen parashikime të përgjithshme, p.sh., ndryshimet në rritjen e kërkesës për udhëtime biznesi dhe argëtimi ose për ujë, sipas llojit të përdoruesit (industrial, të biznesit, institucional ose rezidencial).

5. Analiza e opsioneve

Përse kemi nevojë për analizën e opsioneve?

Qëllimi i analizës së opsioneve është të krahasohen dhe vlerësohen zgjidhjet e mundshme jo-investimi ose investimi⁵. Qëllimi i analizës së opsioneve është të përcaktojë se cila nga këto zgjidhje është më e dobishme dhe duhet zgjedhur për zbatimin e projektit. Analiza e opsioneve është një nga analizat më të vështira, por në të njëjtën kohë një nga analizat më të rëndësishme në përgatitjen e projektit.

Gjatë përgatitjes së projektit, duke qenë se mblidhet më shumë informacion për nevojat, mjedisin e projektit dhe zgjidhjet e mundshme, lista e opsioneve mund të ndryshojë. Mund të ketë pasur disa opsione që janë refuzuar për ndonjë arsye në fazat e mëparshme (PCN). Duhet që ato të përmenden në studim fisibiliteti dhe të tregohen arsyet e rëndësishme se përse analizat e tyre të mëtejshme janë braktisur. Kjo do të tregojë se kontraktori/promovuesi i projektit ka marrë në konsideratë një numër zgjidhjesh alternative dhe nuk ka lënë jashtë asnjë zgjidhje të rëndësishme.

Në fund të fundit, duhet të krahasohen opsionet që janë të realizueshme dhe çojnë në zgjidhjen e problemit të identifikuar në Kapitullin 3, "*Nevojat dhe objektivat e projektit*". Nëse ka shumë opsione të mundshme, veçanërisht në projekte më të mëdha, duhet të merret parasysh një studim paraprak fizibiliteti, në mënyrë që të kufizohet numri i zgjidhjeve që do të merren parasysh në fazën përfundimtare.

Gjatë përcaktimit të zgjidhjeve alternative, është thelbësore t'i referohemi gjithashtu një opsioni "biznes-si zakonisht" (varianti 0), ndaj të cilit projekti dhe opsionet e listës së ngushtë do të krahasohen. Megjithatë, ky variant 0 nuk mund të konsiderohet një opsion pasi nuk çon në zgjidhjen e problemit që është identifikuar. Duhet mbajtur parasysh që të krahasohen opsionet që çojnë në rezultate të ngjashme, në drejtim të përgjigjes ndaj një nevoje të identifikuar dhe zgjidhjes së problemit kryesor.

Metodat për krahasimin e opsioneve

Në thelb, ekzistojnë tre metoda më të zakonshme të krahasimit të opsioneve:

- Analiza me shumë kritere (MCA)

⁵ Analiza e opsioneve synon të identifikojë zgjidhjen e preferuar. Ajo jep përgjigje për një pyetje të rendit të parë. Pasi të identifikohet zgjidhja e preferuar, mund të kërkohet analizë e mëtejshme e varianteve teknike. Për shembull, në një projekt për rrugë, zgjedhja e korridorit ose e një rruge të re kundrejt një zgjidhjeje të ndryshme investimi ose jo-investimi do të konsiderohej në analizën e opsioneve. Ndryshimet në shtrirjen vertikale dhe horizontale të zgjidhjes së preferuar do të konsideroheshin si variante teknike. Zgjedhja e variantit teknik është një pyetje e rendit të dytë.

- Analiza e kosto-efektivitetit (CEA)
- Analiza kosto-përfitim (CBA).

MCA-ja është më e lehta për t'u përdorur, ku një sistem me kritere dhe rëndësi përdoret për të vlerësuar opsionet individuale, duke u caktuar atyre pikë. Metoda CEA krahason kostot gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit me rezultatet e arritura (p.sh. sa kushton mesatarisht për të trajtuar 1 m³ ujëra të zeza komunale gjatë 30 viteve) dhe zgjedh opsionin me kosto më efektive. Metoda më komplekse dhe më e kërkuar është CBA e plotë, ku kostot dhe përfitimet vlerësohen për opsionet individuale dhe llogariten treguesit e efikasitetit ekonomik. Mund të ndodhë që në një rast të caktuar të përdoret më shumë se një metodë.

Më shumë informacion mbi MCA-në dhe CEA-në jepet në Udhëzimet e KE-së (*Shtojca IX. Mjete të tjera vlerësimi*). CBA-ja është përshkruar gjerësisht në Udhëzimet e KE-së.

Cilat opsione mund të merren parasysh?

Parashikohet që opsione të ndryshme investimi (dhe jo-investimi) mund të merren parasysh në analizë, në varësi të karakteristikave të projektit:

- Analiza e opsioneve të mundshme të vendndodhjes së projektit, me qëllim përcaktimin e vendndodhjes më të mirë për projektin⁶. Kjo do të jetë e rëndësishme, për shembull, në rastin e objekteve të mbetjeve të ngurta, impianteve të trajtimit të ujërave të zeza, objekteve sportive, rrugëve të reja më të mëdha (të ashtuquajturat "studim korridori"). Krahasimi i opsioneve të ndryshme të vendndodhjes duhet të marrë parasysh rreziqet e shkaktuara nga ndryshimet klimatike dhe disa çështje të tjera të rëndësishme për projektin, të tilla si pronësia e tokës dhe aksesit në terren ose çështjet e planifikimit hapësinor.
- Qasja strategjike mbi mënyrën e trajtimit të problemit p.sh. rinovimi i objekteve publike ekzistuese në vend që të ndërtohen të reja.
- Përdorimi i qasjeve të ndryshme teknologjike ose teknologjive të ndryshme. Kjo mund të ndryshojë balancën ndërmjet shpenzimeve kapitale dhe periodike, si p.sh. duke zgjedhur ndërmjet ofrimit të shërbimeve pak a shumë intensive kapitale.
- Përmirësimi i zbatimit të masave ose iniciativave ekzistuese në vend të investimit (p.sh. ndërtimi i një rruge të re nuk është mënyra e vetme për të reduktuar kostot e udhëtimit dhe për të përmirësuar sigurinë. Ka mënyra të tjera për të arritur këto rezultate, të tilla si përmirësimi i menaxhimit të trafikut, tarifimi i mbipopullimit/dyndje dhe instalimi i kamerave të shpejtësisë. Disa nga këto opsione nuk do të kenë nevojë për investime kapitale).
- Ndryshimi i kohës, fazave dhe shkallës të investimit kapital (p.sh. duke bërë fillimisht një objekt më të vogël dhe duke e zgjeruar atë kur kërkesa arrijn nivele më të larta).
- Zgjidhje të ndryshme institucionale. Opsionet e projektit mund të përfshijnë masa të tjera përveç shpenzimeve për asetet e reja kapitale të sektorit publik dhe ofrimin e drejtpërdrejtë publik të shërbimeve, të tilla si përmirësimi i kontrollit rregullator ose subvencionet për ofruesit e shërbimeve të sektorit privat.

Në kapitullin ku trajtohet analiza e opsioneve nuk sugjerohet në asnjë mënyrë një renditje për këtë punë. Analiza e opsioneve është një proces përsëritës dhe nuk është një fazë e veçantë dhe e izoluar në përgatitjen e studimit të fizibilitetit. Është e dobishme të kufizohen opsionet sa më shpejt që të jetë e mundur, por kjo nuk duhet të pengojë kalimin tek zgjedhjet, nëse informacioni ose analiza e re ka një

⁶ Në shumicën e rasteve vendndodhja duhet të përcaktohet në një fazë më të hershme (planifikimi strategjik/master planifikim). Më pas FS duhet të shpjegojë vetëm arsyet e vendimit që tashmë është marrë.

ndikim. Në kapitullin mbi analizën e opsioneve duhet të përfshihet tërësia e procesit të përcaktimit të opsionit të preferuar.

Paraqitja e rezultateve

Studimi i fizibilitetit duhet të paraqesë logjikën dhe kriteret që përdoren për secilën fazë të analizës. Analiza e opsioneve duhet të përmbajë një përshkrim të sintetizuar të analizës së zgjidhjeve, për të paktën dy alternativa (opsione) për secilin dimension/fazë të analizës të paraqitur më sipër, të vlerësuar sipas kriterëve të përcaktuara qartë, duke përfshirë kriteret e ndryshimit të klimës. Analiza e opsioneve nuk duhet të konsiderohet si një aktivitet më vete, por si pjesë e analizës më të gjerë të kryer në kuadër të analizës ekonomike. Pavarësisht nga metoda e përdorur, në këtë kapitull duhet të përshkruhet logjika dhe një përmbledhje.

Si pasojë e analizës së opsioneve, opsioni i preferuar duhet të paraqitet dhe të arsyetohet tërësisht. Përshkrimi i duhur duhet të tregojë mënyrën se si çështjet e zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike (duke treguar skenarin e ndryshimit dhe llojin e ngjarjeve të analizuara) janë marrë parasysh në analizën e opsioneve, me kusht që vlerësimi i riskut klimaterik të ketë identifikuar një nevojë të tillë.

6. Studimet teknike

6.1. Sondazhet në terren

Çështjet specifike për kantierin e ndërtimit duhet të kenë fokus të konsiderueshëm dhe të përshkruhen në studimin e fizibilitetit. Studimi i fizibilitetit, kërkon studime më të detajuara në terren. Do të ishte e vështirë të paraqitej fizibilitet teknik ose vlerësime të besueshme të kostos pa kryer hetime ose prova në terren. Kryerja e sondazheve gjeoteknike, për shembull, shpesh është e nevojshme për të marrë informacion mbi karakteristikat fizike të tokës, të cilat mund të ndikojnë ndjeshëm në vlerësimet e kostos së ndërtimit. Në mënyrë të ngjashme, të drejtat e aksesit në kantieret e ndërtimit janë një arsye e zakonshme për vonesat në projekte dhe duhet të analizohen. Ky subjekt duhet të jetë pjesë e vlerësimit teknik, së bashku me një shpjegim mbi mënyrën e kapërcimit të ndonjë problemi ose duhet të ketë një formulim që deklaron se nuk ka probleme në lidhje me aksesin në vend. Sjellja e shërbimit të energjisë elektrike, gazit, ujit, ujërave të zeza dhe të komunikimit në kantier/vend apo edhe rrugë të reja shërbimi janë sfida të zakonshme në shumë projekte. Përsëri, vlerësimi teknik duhet të analizojë disponueshmërinë dhe mjetet me të cilat të gjitha shërbimet e kërkuara mund të sillen në vendin e projektit.

6.2. Rishikimi i çështjeve të planifikimit hapësinor

Duhet të paraqitet një përshkrim specifik, i mbështetur me harta dhe dokumente të tjera të aplikueshme, përkatëse për vendndodhjen e projektit, duke marrë parasysh dokumentet e mëposhtme⁷:

- Planin e përgjithshëm kombëtar të territorit (PPKT);
- Planet kombëtare sektoriale, që mbulojnë të gjithë territorin ose pjesërisht;
- Planin e detajuar të zonave me rëndësi kombëtare;
- Planet e zhvillimit rajonal;

⁷Sipas nenit 15 të ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”

- Planin e përgjithshëm vendor të territorit (PPVT);
- Planin e detajuar vendor (PDV);
- Çdo dokument tjetër përkatës.

Përshkrimi duhet të justifikojë që projekti dhe zona përreth janë në përputhje me supozimet dhe kërkesat e të gjitha planeve përkatëse të zhvillimit hapësinor. Nëse dokumentet përkatëse hapësinore përfshijnë zonimin e informuar për klimën, kjo do të nënkuptojë gjithashtu reduktimin e rreziqeve të ndryshimeve klimaterike në lidhje me vendndodhjen e projektit.

6.3. Marrja e tokës

Duhet të paraqitet struktura e pronësisë për të gjitha parcelat e nevojshme për zbatimin e suksesshëm të projektit. Duhet të tregohet gjithashtu nëse organi përgjegjës për projektin ka një bazë për blerjen e të gjithë tokës së kërkuar.

Aty ku kërkohet shpronësim, shqyrtimi sa më herët i çështjeve që duhen zgjidhur për zbatimin e projektit, është thelbësore për zbatimin në kohë të projektit. Do të ketë implikime ligjore, financiare dhe administrative, si dhe konsultime dhe negociata me palët e interesuara. Analizat dhe konsultimet tashmë të kryera duhet të përshkruhen në këtë seksion, të ndjekur nga një plan i qartë i hapave të mëtejshëm. Kostot e kompensimit dhe zhvendosjes duhet të përfshihen në analizën financiare.

6.4. Projekti teknik paraprak

Çdo projekt propozim duhet të përmbajë një përshkrim të aspekteve të tij teknike. Të gjitha projektet kanë një shkallë të kontributit teknik; herë domethënëse e herë modeste. Bazuar në studimet teknike dhe analizën e opsioneve të përshkruara më sipër, dizajni teknik i përzgjedhur duhet të paraqitet dhe justifikohet. Të gjitha aspektet kryesore dhe komponentët e projektit teknik duhet të përshkruhen këtu, ndërsa informacion më të detajuar duhet të jepet në dokumentet teknike bashkëngjitur.

7. Objekti përfundimtar i projektit

Objekti i projektit, pjesët përbërëse të tij dhe aktivitetet e propozuara, duhet të jenë mjaftueshëm të gjera për të kapur të gjitha shpenzimet e nevojshme për të ofruar rezultatet e projektit dhe për të arritur objektivat e synuara. Përveç zgjidhjes teknike qendrore, qëllimi i projektit zakonisht përfshin të paktën një prej elementeve të mëposhtme:

- Blerjen e pajisjeve;
- Sigurimin e trajnimit të stafit;
- Zhvillimin e sistemit të TI-së;
- Mbikëqyrjen e ndërtimit (nëse planifikohet të prokurohet nga jashtë);
- Fushatën e ndërgjegjësimin social;

Kjo listë nuk është shteruese dhe projekti mund të përfshijë elementë të tjerë. Parimi është se objekti i projektit duhet të shtrihet në të gjithë elementët e nevojshëm për të ofruar përfitime të qëndrueshme.

8. Kostot financiare të projektit dhe plani i zbatimit të projektit

Ky kapitull synon të ofrojë vlerësim të kostos për secilin nga komponentët e projektit të përcaktuar në kapitullin e mëparshëm dhe planin e zbatimit të projektit.

8.1. Vlerësimi i kostove financiare të projektit

Objekti i projektit mund të përfshijë kategori të ndryshme kostosh, duke përfshirë kostot kapitale të të gjitha aktiveve fikse dhe aktiveve jofikse. Shembuj të kostove tipike kapitale:

- Kostot e zhvillimit, duke përfshirë kostot e stafit dhe konsulencës dhe tarifat e tjera profesionale;
- Blerjet e tokës dhe ndërtesave;
- Tarifat për liçencat dhe lejet në lidhje me projektin;
- Kostot e përgatitjes së vendit;
- Punimet përkatëse të infrastrukturës (ruga e hyrjes në kantier, lidhjet e shërbimeve);
- Ndërtimin;
- Kostot sociale dhe e zbutjes mjedisore;
- Blerjet e pajisjeve, automjeteve, harduerit dhe softuerit në lidhje me projektin;
- Kostot e instalimit, zbatimit dhe komisionimit;
- Shpenzimet e mbikëqyrjes;
- Kontigjencat;

Kostot duhet të llogariten për të gjitha kategoritë e buxhetit të projektit. Në fazën e studimit të fizibilitetit, vlerësimet e kostos zakonisht duhet të përgatiten nga inxhinierët/ekspertët teknikë mbi bazën e një projekti paraprak të infrastrukturës përkatëse që rezultojnë në një faturim paraprak të sasive. Vendosija e kostos së këtyre sasive duhet të bazohet në analizën e tregut.

8.2. Plani i zbatimit të projektit

Në planin material dhe financiar duhet të pasqyrohet zbatimi i planifikuar i projektit dhe kostot që lidhen me zbatimin e këtij projekti. Ai duhet të jetë në përputhje me aktivitetet e përshkruara në kapitullin "*Objekti i projektit*".

9. Analiza financiare ⁸

9.1. Objekti i analizës financiare të paraqitur në këto udhëzime mund të zgjerohet nëse është e nevojshme, duke marrë parasysh natyrën dhe/ose strukturën ligjore dhe financiare të projektit. Metodatat dhe supozimet

Në këtë kapitull duhet të paraqiten, përshkruhen dhe justifikohen metodatat dhe të gjitha supozimet e aplikuara për qëllimin e kryerjes së analizës financiare, duke përfshirë supozimet për skenarët makroekonomikë dhe periudhën e zgjedhur të referencës për analizën, si më poshtë:

- Skenarët makroekonomikë

⁸Modeli financiar-ekonomik i përdorur përbën një shtojcë të detyrueshme të Studimit të Fizibilitetit.

Rekomandohet të përgatitet një analizë në terma realë, por tendencat makroekonomike janë të rëndësishme në rast të ndryshimeve në çmimet relative, p.sh., një rritje më e shpejtë e çmimeve të energjisë sesa inflacioni. Gjithashtu, ndryshimet në kurset e këmbimit mund të kenë ndikim në çmimet e ardhshme të inputeve dhe supozimet e përdorura duhet të shpjegohen.

- Periudha e referencës (afati kohor)

| Sektori | Vitet |
|--------------------------------|-------|
| Hekurudhat | 30 |
| Rrugët | 25-30 |
| Portet dhe aeroporti | 25 |
| Transporti urban | 25-30 |
| Furnizimi me ujë & kanalizimet | 30 |
| Menaxhimi i mbetjeve | 25-30 |
| Energjia | 15-25 |
| Brezi i gjerë | 15-20 |
| Infrastruktura e biznesit | 10-15 |
| Sektorë të tjerë | 10-15 |

Burimi: 'Udhëzues për analizën kosto-përfitim të projekteve investuese: Mjeti i Vlerësimit Ekonomik për Politikën e Kohëzimit 2014-2020', DG për Politikat Rajonale dhe Urbane, Komisioni Evropian, 2014

Të gjitha supozimet e tjera përkatëse duhet të përcaktohen.

9.2. Vlerësimet e kostove të investimeve financiare, kostove operative dhe të ardhurave gjatë kohëzgjatjes së projektit⁹

Vlerësimet e kostove totale të investimit të projektit, si dhe kostot operative dhe të ardhurat vjetore (nëse është e aplikueshme) së bashku me bazën e vlerësimit të tyre duhet të paraqiten këtu.

Kostoja totale e investimit të një projekti përbëhet nga:

- kostot fillestare të investimit (Vlera e buxhetit të projektit duhet të jetë në përputhje me kapitullin që paraqet vlerësimin e kostos së projektit);

⁹ Në këtë seksion trajtohen kostot financiare të projektit. Kostot ekonomike mund të ndryshojnë dhe kërkojnë rregullime të kostove financiare, siç do të përcaktohet në kapitull 10.

- kostot e zëvendësimit, të cilat lidhen me kostot që ndodhin gjatë afatit kohor të një projekti për zëvendësimin e makinerive dhe/ose pajisjeve, të cilat do të duhet të përfshihen në shpenzimet gjatë fazës operacionale;

Kostot operative përfshijnë të gjitha kostot që lidhen me funksionimin dhe mirëmbajtjen e shërbimit të ri ose të përmirësuar, që rrjedhin nga projekti. Shembuj të kostove tipike operative:

- Kostot e punës (pagat dhe sigurimet shoqërore);
- Kostot e shërbimeve;
- Lënda djegëse;
- Materialet;
- Kostot e sigurisë;
- Kostot e mirëmbajtjes (mirëmbajtje ose riparim i vogël i aseteve);
- Shërbimet e zyrës (p.sh. shërbimet online, përpunimi i të dhënave);
- Shpenzimet e qirasë dhe qiradhënies (qiraja e ndërtesave/zyrave, marrja me qira e makinerive);
- Pastrimi;

Të ardhurat e projektit përfshijnë hyrjet e parave për mallrat ose shërbimet e ofruara nga projekti, p.sh.:

- Tarifat direkte për përdorimin e infrastrukturës (taksat e autostradës);
- Shitja ose qiraja e tokës ose ndërtesave (dhënia me qira e zyrave ose klasave);

Vlera e këtyre të ardhurave do të përcaktohet në parashikim nga çmimet e tyre dhe nga sasitë e vlerësuara të mallrave ose shërbimeve të ofruara gjatë viteve të funksionimit.¹⁰

Vlera e mbetur duhet të përfshihet si e ardhur në vitin e fundit të analizës.

9.3. Financimi i projektit

Në këtë kapitull duhet të jepet një shpjegim të burimeve të financimit që do të përdoren për të mbuluar kostot e investimit (p.sh. buxheti i shtetit – grantet, subvencionet, mbështetje kapitale në nivele të ndryshme qeveritare; kontributi privat sipas PPP-së – dhe kreditë).

9.4. Përbalueshmëria e buxhetit

Duhet të përfshihet një analizë buxhetore për të përcaktuar ndikimin neto që një projekt do të ketë në buxhetin publik gjatë fazave të zbatimit dhe funksionimit të një projekti dhe për të ndihmuar në përcaktimin nëse një investim i tillë mund të përballohet nga perspektiva fiskale. Një analizë e plotë e ndikimit buxhetor merr parasysh të gjitha flukset financiare të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta që kanë ndikim në financat publike, jo vetëm ato që prekin njësinë operative të projektit.

¹⁰Duhet të theksohet se shumë projekte publike nuk do të prodhojnë të ardhura. Në këto raste, analiza financiare ka më pak rëndësi, por megjithatë mund të ofrojë informacion të rëndësishëm. Ajo do të përcaktojë vlerat financiare të kostove që përdoren më pas në analizat ekonomike (të rregulluara sipas nevojës). Analiza do të tregojë gjithashtu se çfarë mbështetje financiare i nevojitet projektit nga fondet publike, për ta bërë atë financiarisht të qëndrueshëm. Ky aspekt lidhet edhe me çështjen e ndikimit buxhetor të projektit.

9.5. Analiza financiare e fluksit monetar

Analiza financiare (si dhe ajo ekonomike) duhet të kryhet bazuar në një model financiar diferencial, të përgatitur për një projekt që krahason fluksin monetar për njësinë ekonomike në skenarin "me projekt" dhe me ato në skenarin "pa projekt".

Mënyrat kryesore të paraqitjes së rezultateve të analizës financiare të fluksit monetar janë:

- Vlera aktuale neto financiare e projektit;
- Norma e brendshme financiare e kthimit;

Këtu duhet theksuar se vlerësimi i përfitimit financiar të projekteve publike nuk është një element vendimtar në zbatimin apo braktisjen e tyre. Prandaj, është e pranueshme të merret një vendim për zbatimin e projektit edhe nëse treguesit e përfitimit financiar janë negativ. Konfirmimi përfundimtar i ligshmërisë së projektit duhet të pasqyrohet në analizën ekonomike.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i analizës financiare është qëndrueshmëria financiare. Projekti është financiarisht i qëndrueshëm kur rreziku i mbarimit të parave të gatshme në të ardhmen, si gjatë fazës së investimit ashtu edhe gjatë fazës operative, pritet të jetë zero. Kjo do të thotë që analiza duhet të tregojë se si do të mbulohet çdo mungesë financiare, nëse identifikohet ndonjë, në mënyrë që në skenarin "me projekt" Investitori/Subjekti operativ të ketë bilanc pozitiv në para në fund të çdo viti¹¹.

10. Analiza ekonomike

10.1. Metodatat dhe supozimet

Në këtë kapitull duhet të paraqiten, përshkruhen dhe arsyetohen metodatat dhe supozimet e aplikuara për qëllimin e kryerjes së analizave ekonomike.

Analiza e kosto-përfitimit ekonomik është përgatitur nga analiza financiare e fluksit monetar (duke sjellë ndërmend se për shumë projekte të sektorit publik nuk do të ketë hyrje financiare në formën e të ardhurave). Qëllimi kryesor i një analize ekonomike është shqyrtimi i justifikimit për një investim nga këndvështrimi i shoqërisë në tërësi¹² dhe përcaktimi nëse burimet ekonomike të nevojshme për një projekt përdoren mirë, që do të thotë nëse përfitimet e një projekti tejkalojnë koston e burimeve të përdorura në proces. Analiza ekonomike përfshin korrigjimet për shtrembërimet e rëndësishme të tregut dhe vlerësimin e kostove dhe përfitimeve për të cilat çmimet e tregut nuk ekzistojnë. Ka shumë burime të shtrembërimeve të tregut, duke përfshirë:

- tregjet joefikase ku sektori publik dhe/ose operatorët ushtrojnë tagrat e tyre (p.sh. subvencionet për prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme, çmimet duke përfshirë një rritje mbi koston marxhinale në rastin e monopolit, etj.);
- tarifatat e administruara për shërbimet komunale mund të dështojnë të pasqyrojnë koston oportune të inputeve për shkak të përballueshmërisë dhe arsyeve të barazisë;


¹¹ Shihni seksionin 2.7.7 të Udhëzimeve të KE-së për më shumë detaje mbi kryerjen e analizës së qëndrueshmërisë financiare.

¹² Prandaj, analiza ekonomike-kosto-përfitim referohet edhe si 'analizë kosto-përfitim social'.

- disa çmime përfshijnë kërkesat fiskale (p.sh. detyrimet në import, akcizat, TVSH-në dhe taksat e tjera indirekte, tatimin mbi të ardhurat mbi pagat, etj.);
- për disa efekte nuk ka treg (dhe çmime) (p.sh. reduktimi i ndotjes së ajrit, kursimi i kohës).

Metodologjia e kalimit nga një analizë financiare në atë ekonomike ka hapat kryesorë të mëposhtme:

- **Korrigjimet fiskale.** Shpesh në flukset monetare financiare ka zëra që janë vetëm transferta brenda ekonomisë kombëtare dhe nuk përfaqësojnë kosto ekonomike, d.m.th. shfrytëzimin e burimeve. Subvencionet dhe taksat indirekte, p.sh. TVSH-ja, përfaqëson një transferim të tillë dhe duhet të përjashtohet nga analiza ekonomike.¹³
- **Shndërrimi i çmimeve të tregut në çmime ekonomike/hije.** Kjo mund të jetë e nevojshme kur çmimet e tregut nuk pasqyrojnë koston oportune të inputeve dhe outputeve. Outputet shpesh ofrohen falas (ose me një tarifë minimale) kështu që gatishmëria e përdoruesve për të paguar duhet të matet për të vendosur një çmim ekonomik. Nga ana tjetër, çmimet e inputeve mund të shtrembërohen dhe duhet të rregullohen duke përdorur faktorin e konvertimit ose metoda të tjera për t'i përshtatur ato për të pasqyruar koston reale ekonomike të burimeve¹⁴. Hapat e detajuar në lëvizjen nga çmimet e tregut në ato hije janë të ilustruara në figurën e mëposhtme:



Burimi: Udhëzimet e KE-së

- **Përfshirë eksternalitetet.** Një eksternalitet është çdo kosto ose përfitim që zbulohet nga projekti drejt palëve të tjera pa kompensim monetar p.sh. eksternalitetet tipike në sektorin e transportit janë koston për emetimet e zhurmës dhe ndotësve të ajrit ose përfitimet për jo-

¹³Për më shumë informacion, referojuni Udhëzimeve të KE-së (seksioni 2.8.2, 'Korrigjimet fiskale').

¹⁴ Për më shumë informacion, referojuni Udhëzimeve të KE-së (seksioni 2.8.3, "Nga çmimet e tregut në hije" dhe seksionet pasuese për më shumë detaje mbi specifikat).

përdoruesit për shkak të uljes së mbipopullimit/dyndjes në mënyrat ose rrugët alternative të transportit.

- **Zbritja e flukseve monetare neto dhe llogaritja e treguesve të performancës ekonomike (Vlera aktuale ekonomike neto dhe norma e brendshme ekonomike e kthimit):** kostot dhe përfitimet e ardhshme duhet të zbriten deri në ditët e sotme (për të dhënë vlerat aktuale) sepse shoqëria e vlerëson konsumin sot më shumë se konsumin nesër.

E njëjta periudhë referimi (horizonti kohor) për analizën ekonomike duhet të jetë siç zbatohet në analizën financiare. Për llogaritjen e treguesve të analizës ekonomike duhet të përdoret norma e skontimit social. Kjo do të ndryshojë nga norma e skontimit e aplikuar në analizën financiare, e cila duhet të pasqyrojë koston e kapitalit për subjektin në fjalë.

Në përputhje me udhëzimet e KE-së, **norma e skontimit social prej 5%** duhet të përdoret për të gjitha llogaritjet e vlerës aktuale deri në momentin kur një normë e re të lëshohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë¹⁵.

10.2. Vlerësimi i kostove dhe përfitimeve, duke përfshirë emetimet e gazeve serrë (GHG)

Ekzistojnë disa rregulla në lidhje me vlerësimin e kostove dhe përfitimeve ekonomike:

- **Proporcionaliteti** – përpjekjet e bëra për të analizuar kostot dhe përfitimet duhet të jenë proporcionale me madhësinë e një projekti (projektet më të mëdha kërkojnë një analizë më të thelluar).
- **Qasja në rritje** – kostot dhe përfitimet duhet të vlerësohen duke iu referuar Variantit 0 (skenari "pa projekt").
- **Përdorimi i çmimeve në terma realë.**
- **Qasjet e bazuara në treg** – përfitimet e projektit, të cilat shpesh janë të vështira për t'u vlerësuar për shkak të faktit se shumë shërbime publike janë pa pagesë, duhet të vlerësohen bazuar në gatishmërinë e përdoruesve të mundshëm për të paguar ose gatishmërinë për të pranuar.

Gatishmëria për të paguar është një pagesë maksimale nga e cila një përfitues do të ishte i gatshëm të hiqte dorë që të mernte një shërbim publik. Në mënyrë të ngjashme, gatishmëria për të pranuar llogaritjet për përfitimet dhe përfaqëson pagesën minimale që dikush do të pranojë për të jetuar me një shqetësim, si p.sh. rritje e ndotjes akustike. Gatishmëria e përdoruesve të mundshëm për të paguar ose gatishmëria për të pranuar mund të vlerësohen duke përdorur preferencat e zbuluara (të preferuara dhe më pak sfiduese teknikisht) dhe preferencat e deklaruara (kur preferencat e zbuluara nuk janë të mundshme). Qasja e dekluarar e preferencave kërkon këshilla të ekspertëve për të hartuar dhe interpretuar sondazhet. Duhet të nënvizohet se metoda duhet të përdoret kur përfitimi/kostoja është thelbësore për vendimin dhe analiza e sensitivitetit duhet të zbatohet gjithmonë për rezultatet.¹⁶

Kostot dhe përfitimet e identifikuara duhet të paraqiten dhe përshkruhen në këtë pikë, së bashku me vlerësimin e tyre në terma parash.

¹⁵ Udhëzimet e KE-së lejojnë që vendet të vlerësojnë normat e tyre të skontimit social, me kusht që përdorimi i parametrave specifikë të vendit mund të justifikohet siç duhet.

¹⁶Për detaje shihni: Seksionet 2.8.6 dhe 2.8.7 të Udhëzimeve KE-së.

Në terma ndërkombëtare, një kosto e konsiderueshme (dhe ndonjëherë përfitim) e një projekti është rritja/ulja e emetimeve të gazeve serrë. Ndikimi i gazrave serrë është global, afatgjatë dhe i nënshtrohet angazhimeve ndërkombëtare, prandaj duhet të konsiderohet me kujdes në dokumentacion. Në analizë duhet të paraqitet masa e vëllimit të emetimeve të emetuara ose të kursyera shtesë në atmosferë për shkak të projektit. Hapi tjetër është vlerësimi i eksternalitetit duke përdorur një kosto për njësi të ekuivalentit të CO₂.¹⁷

10.3. Vlerësimi i efekteve që nuk kapen nga vlerësimi ekonomik

Jo të gjitha përfitimet mund të vlerësohen në terma monetarë. Ato kosto dhe përfitime, të cilat nuk mund të ishin vlerësuar në terma parash, duhet të paraqiten dhe të përshkruhen në këtë kapitull. Ku është e mundur, këto kosto dhe përfitime duhet të shprehen në sasi fizike. Supozimet e bëra në tregues duhet të jenë transparente në mënyrë që të mund të kontrollohen dhe (nëse është e nevojshme) të kundërshtohen nga vlerësuesit.

10.4. Analiza e kostos - përfitimit dhe performanca ekonomike

Pasi të gjitha kostot dhe përfitimet e projektit janë llogaritur dhe vlerësuar në terma monetarë, është e mundur të matet performanca ekonomike e projektit duke llogaritur treguesit e mëposhtëm:

- **Vlera aktuale ekonomike neto** është diferenca ndërmjet përfitimeve totale sociale të skontuara dhe kostove.
- **Norma e Brendshme Ekonomike e Kthimit** është norma e skontimit që prodhon një vlerë zero për ENPV-në.

Në parim, çdo projekt me një normë të brendshme ekonomike kthimi më të ulët se norma e skontimit social ose një vlerë aktuale ekonomike neto negative duhet të refuzohet. Një projekt me një kthim negativ ekonomik përdor shumë burime të vlefshme shoqërore për të arritur përfitime shumë modeste për të gjithë qytetarët.

Zbatimi specifik i analizës ekonomike ndryshon sipas sektorit.

Ndërsa rezultatet e analizës ekonomike duhet të jenë shumë të rëndësishme në informimin e rekomandimeve të studimit të fizibilitetit dhe vendimit të vlerësimit, faktorë të tjerë mund të ndikojnë në vendimin përfundimtar, duke përfshirë kostot ose përfitimet e rëndësishme që nuk janë monetizuar dhe faktorët e qëndrueshmërisë.

¹⁷Për detaje shihni: Seksionin 2.8.8 të Udhëzimeve të KE-së, Vlerësimi i emetimeve të GHG-së.

11. Analiza e vlerës për para për partneritetet publike private

11.1. Qasja metodologjike

Ky kapitull zbatohet vetëm për projektet që do të zbatohen sipas modalitetit PPP.

PPP është një modalitet zbatimi që mund të përdoret në projekte publike, kur justifikohet. Analiza që krahason efikasitetin e zbatimit të projektit në formulën PPP në krahasim me formulën tradicionale të zbatimit nga Subjekti Publik emërtohet analiza "Vlera për Paranë".¹⁸

Analiza e vlerës për para duhet të kryhet për çdo projekt PPP-je pasi të konfirmohet fizibiliteti i tij (duke përfshirë efektivitetin ekonomik). Qëllimi i tij është t'i përgjigjet pyetjes nëse projekti në shqyrtim duhet të zbatohet duke përdorur PPP-në apo metodën tradicionale. Analiza e vlerës për para duhet të kryhet për projektet që janë treguar si potencialisht të zbatueshme duke përdorur modalitetin PPP në fazën e plotësimit të formularit të konceptimit të projektit të investimit, kur duhet të ishin identifikuar arsyet paraprake për marrjen në konsideratë të kësaj qasjeje.

Analiza e vlerës për para përfshin analizën cilësore dhe analizën sasore.

11.2. Analiza cilësore e vlerës për para

